



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA DOGANORE

---

**RAPORT  
PËR PUNËN E DREJTORISË DOGANORE NË  
VITIN 2010**

**Prill 2011**

## PËRMBAJTJA

HYRJE .....	5
<b>I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË.....</b>	<b>6</b>
1. Aderimi te sistemi tranzit i përbashkët dhe anëtarshimi në BE.....	6
Përkrahja nga fondet IPA të Komisionit Evropian.....	6
Legjislacioni.....	6
Lidhja dhe interoperabiliteti me sistemet informatike të BE.....	7
2. Lehtësimet doganore dhe tatimore.....	7
3. Thjeshtëzimi dhe përsheptimi i procedurave doganore dhe tatimore.....	8
Korniza juridike.....	8
e-Dogana.....	9
Internet portali për dorëzimin elektronik të kërkesave deri te DD.....	9
4. Akciza.....	11
5. Autorizimet dhe licencat doganore.....	11
6. Vëllimi i punës.....	12
<b>II. KONTROLLI DHE ZBATIMI I LIGJEVE.....</b>	<b>13</b>
7. Forcimi i mëtejshëm të kapacitetit për analizë të rrezikut.....	13
8. Forcimi I mëtejshëm i kapacitetit për kryerjen e kontrollit dhe hetimit doganor.....	14
9. Laboratoria doganore.....	15
10. Rezultatet nga mbikëqyrja doganore dhe kontrolli.....	15
Ndalimi i kontrabandës dhe malli i konfiskuar përkohësisht.....	15
Ndalimi i tregtisë jolegale me narkotikë dhe materie psikotrope.....	18
Mbartja jolegale e parave të gatshme.....	18
Ndalimi i emigracionit ilegal.....	18
Zbulimi i nivelit të lartë të rrezatimit jonizues.....	18
Operacionet ndërkombëtare.....	18
11. Mbrojtja e të drejtave nga pronësia intelektuale.....	19
Rezultate.....	19
12. Kontrolli dhe hetimi.....	20
Kontrolli i shoqërive tregtare.....	20
Kontrolli i dokumenteve doganore.....	21
Kundërvajtjet doganore.....	21
Veprat penale.....	21
13. Mbledhja e të dhënave importuese.....	21
Dogana dhe të dhënat doganore.....	21
Të ardhurat e mbledhura nga TVSH.....	22
Të ardhurat e mbledhura nga akcizat.....	23
<b>III. BURIMET NJERËZORE.....</b>	<b>24</b>
14. Përparimi i sistemit për menaxhimin me burimet njerëzore.....	24
15. Trajnim dhe përparimi i aftësive profesionale.....	24
Realizimi i programit për trajnim në Drejtorinë doganore 2010.....	25
Trajtime përmes programit TAIEK të Komisionit Evropian.....	26
16. Integriteti dhe lufta kundër korrupsionit.....	26
Përkrahja e sistemit.....	26
Njësia doganore më e mirë.....	26

Aktivitete e sindikatës.....	26
17. Shkatërimi i keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe konflikt interesit.....	27
Inspeksioni i mbrendshëm.....	27
Hetimet e mbrendshme.....	27
Procedurat disiplinore.....	28
Kallëzimet penale.....	28
IV. PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE PËRKRAHJA LOGJISTIKE.....	29
18. Procedurat administrative dhe procedurat.....	29
Futja e sistemit elektronik për menaxhimin me dokumentet EDMS.....	29
Rregullimi i punës me vulat dhe amblemat.....	30
Rregullimi i mënyrës së përgatitjes së akateve interne.....	30
Rregullimi i mënyrës së mbledhjes së taksave administrative.....	30
19. Siguria dhe mbrojtja.....	30
20. Kritishtja e efikasitetit në menaxhimin me resurset njerëzore.....	30
Rregullimi i punës financiare dhe materiale me vendosjen e përkrahjes informatike .....	30
Mbindërtim i mëtejshëm i sistemit për kontroll të shpenzimeve.....	31
Mbindërtim i mëtejshëm të sistemit për kontroll të të ardhurave.....	31
Evidentimi kontabël.....	31
21. Kritishtja e efikasitetit në menaxhimin e resurset jofinanciare.....	30
Ndërtimi i vendkalimit kufitar Bllacë.....	32
Lidhja e marëveshjes për bashkëpunim në mes Drejtorisë doganore dhe operatorit të aeroportit TAV Maqedoni.....	32
V. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE NDËRINSTITUCIONAL.....	33
22. Në Ohër është mbajtur konferencë vjetore për 2010 të rajonit të Evropës të OBD.....	33
23. Në Shkup është mbajtur takimi i dytë të Qendrave Rajonale trajnuese të OBD – Rajonet e Evropës.....	33
24. Bashkëpunimi bilateral ndërkombëtar.....	34
25. Bashkëpunimi multilateral ndërkombëtar.....	35
26. Bashkëpunimi me bashkësinë e biznesit.....	35
27. Takimet koordinative donatore.....	36
28. Praktika verore për studentët.....	36
VI. TRANSPARENCA.....	37
29. Internet faqja e Drejtorisë doganore.....	37
30. Linja e hapur telefonike 197.....	38
31. Sugjerime dhe propozime.....	38

Si shërbimet të tjera doganore në botë, Drejtoria doganore e Republikës Maqedonisë është e obliguar për të mbrojtur interesat financiare të Republikës Maqedonisë, sigurinë, shëndetin dhe jetën e qytetarëve, të mbështet aktivitetet ekonomike dhe ti mbroj nga konkurrenca jolojale, si dhe të kontribuon në rritjen e nivelit të konkurrencës të ekonomisë maqedonase me zbatimin e metodave punuese moderne, të përkrahur nga mjedisi i lehtë gasës elektronik doganor.

Në kryerjen e detyrave dhe obligimeve lidhur me kontrollin e kufinjve dhe ofrimin e siguris në zinxhirin e furnizimit, Drejtoria doganore synon të zbaton kornizën e standardeve për lehtësimin dhe sigurimin e tregtisë ndërkombëtare të OBD, si dhe bluprintave doganor të Komsionit Evropian.

Obligimet e tij dhe detyrat punuese Drejtoria doganore i kryen në Drejtorinë Qendrore dhe në 5 Dogana regjionale. Në Drejtorinë doganore ka gjithsejtë 1144 të punësuar. Në drejtorinë Qendrore puna është organizuar në 7 sektore (Departamenti për kontroll dhe hetim, Departamenti për sistem doganor, Departamenti për përgjegjësi profesionale, Departamenti për teknologji informatike dhe komunikative, Departamenti për menaxhimin me burimet njerëzore, Departamenti për kontabël dhe financa, Departamenti për punë administrative dhe teknike) dhe 4 departamente të pavarura ( Departamenti për auditim të mbrendshëm, Departamenti për kundërvajtje, Departamenti për procedurë administrative dhe përfaqësimi në gjykata dhe Departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar, eurointegrim dhe projekte). Qendra të doganave rajonale janë Shkup, Kumanovë, Shtip, Gjevgjeli dhe Manastir. Në kuadër të doganave janë organizuar njësi doganore (19 njësi kufitare dhe 23 njësi të mbrendshme doganore) dhe 5 shërbime për mbikëqyrje të poseduesve të lejeve (nga një në çdo doganë).

Drejtorija doganore, si shërbim doganor të një vendi kandidat për anëtarësim në BE ka të njëjtat qëllime dhe vlera me shërbimet doganore të vendeve anëtare të BE të cilat dalin nga *Acquis Comminitaire*. Aktivitetet për rritjen e kapacitetit administrative për implementimin e legjislacionit doganor dhe përgatitjes së vendit për anëtarësim në BE janë pjesë të përditshme të punës së Drejtorisë doganore. Drejtoria doganore edhe në vitin 2010 ka punuar intenzivisht në miratimin e Acquis Comminitaire, për harmonizimin e legjislacionit nacional me legjislacionin e BE edhe për ndërtimin e kapaciteteve për kontroll efikas të kufinjve.



### I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPËJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË

Drejtoria doganore punon në përgatitjen dhe implementimin e zgjidhjeve të sistemit për lehtësimin dhe përsheptimin e mëtejshëm të transportit dhe tregtisë. Në vitin 2010 përpjekjet e Drejtorisë doganore ishin përqendruar drejt harmonizimit të mëtejshëm me kërkesat në fushat e doganës për aderim të konventa për tranzit të përbashkët dhe anëtarësim në BE, analizimin e gjendjes aktuale dhe komunikimit të drejtpërdrejt me bashkësinë e biznesit për caktimin e mundësive për thjeshtimin e mëtejshëm të procedurave importuese, eksportuese, uljen e shpenzimeve të operatorëve ekonomik, veçanarisht me zbatimin e mjeteve informatike bashkohore.

#### 1. ADERIMI TE SISTEMI TRANZIT I PËRBASHKËT DHE ANËTARËSIMI NË BE

Kushtet themelore të cilat Republika e Maqedonisë duhet ti siguron që të mund të fillon procedura për hyrje të sistemi tranzit i përbashkët dhe për anëtarësim në BE, janë harmonizimi i legjislacionit nacional me Konventën për tranzit të përbashkët të BE dhe lidhjen me sistemet doganore informatike të BE. Në vitin 2010 është vazhduar me harmonizimin e legjislacionit edhe me përgatitjen e sistemit informatik për lidhjen me sistemet informatike të Komisionit Evropian dhe vendet anëtare të BE. Përgatitja i Sistemit nacional për përpunimin e deklaratave është financuar nga buxheti nacional, ndërsa përkrahja teknike për përgatitjen e softverit për lidhjen me sistemet doganore TIK të BE dhe për harmonizimin e legjislacionit nacional me Konventën për tranzit të përbashkët, janë financuar me mjetet e fondeve IPA të Komisionit Evropian.

#### MBËSHËTETJA NGA IPA FONDET TË KOMISIONIT EVROPIAN

Në kuadër të projekteve të financuar nga programi IPA 2007, gjatë vitit 2010 janë realizuar 3 nënprojekte. Në kuadër të nënprojektit për harmonizim të mëtejshëm të legjislacionit nacional doganor me legjislacionin të BE, janë përgatitur ndryshime ose plotësime të Ligjit doganor, Rregullores për zbatimin e Ligjit doganor dhe Rregullores për mënyrën e plotësimit të deklaratës doganore dhe kodit të shifrave, si dhe udhëzimeve interne për procedurat e reja më efektive sipas standardeve të BE, ndërsa është përgatitur edhe specifikim funksional për përpunimin e softverit për kontroll të qarkullimit të akcizave – EMCS. Në kuadër të nënprojektit për përkrahje teknike për përmirësimin e sistemeve doganore TIK, janë përgatitur dokumente strategjike TIK për lidhjen me sistemet informatike doganore të vendeve anëtare të BE dhe Komisionit Evropian, specifikimet teknike për softveret bazë për lidhjen me sistemet TIK doganore të BE, ndërsa është furnizuar edhe pajisje kompjuteristike. Në kuadër të nënprojektit për përforcimin e kontrolleve kufitare janë futur teknika të reja moderne për zbatimin e legjislacionit doganor (teknologji dhe allate nga lloji i analizës së riskut), mbrojtja e kufirit shtetëror dhe lehtësimi të qarkullimit të mallrave përmes kufinjve shtetëror, janë përgatitur dhe promovuar module/trajnime për mësim doganor dhe afarist elektronik (E-mësim) të krijuar nga ana e Komisionit Evropian, ndërsa janë realizuar edhe trajnime të trajnuesve për rritjen e integritetit të nëpunësve doganor. Është siguruar edhe trajnim të qenjëve doganor për zbulimin e drogës dhe është furnizuar pajisje teknike dhe automjete për transportin e tyre.



### I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPËJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË

Përmes mjeteve të siguruara në kuadër të fondeve IPA 2008, në vitin 2010 është zbatuar procedura dhe është luhur kontratë për përgatitjen e softverit për aderim te sistemi i ri tranzit i kompjuterizuar i BE – NCTS dhe për kontroll të kualitetit.

Në vitin 2010 Komisioni Evropian ka sjell vendim me të cilën kompetencat për menaxhimin me komponentën e parë nga Programi IPA transformohen nga Komisioni Evropian në Republikën e Maqedonisë. Me këtë vendim vërtetohet përgatitja e strukturës nacionale (përfshirë edhe Drejtorinë doganore) për vetëmenaxhim me mjetet të BE nga programi IPA për zhvillim të mëtejshëm të kapacitetit administrativ dhe operativ.

Në bashkëpunim me Qendrën për perspektiva evropiane nga Sllovenia, ndërsa përkrahje financiare nga projekti IPA 2007 për afrimin të legjislacionit nacional te ajo e BE, në 2010 janë realizuar trajnime të doganierëve udhëheqës për bisedime dhe paraqitjen e pozicioneve të RM në procesin e bisedimeve për anëtarësim në BE..

### LEGJISLACIONI

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për tarifë doganore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 35/10) është krijuar korniza ligjore për krijimin e tarifës së integruar doganore – TARIM (një lloji i Taric nacional i cili përdoret në BE) në të cilën janë të integruar të gjitha masat tarifore dhe jotarifore, sipas dispozitave në fuqi të Republikës së Maqedonisë. Republika e Maqedonisë përcaktohet për administrator të TARIM.

Në prill 2010 janë sjell ndryshime dhe plotësime të Ligjit doganor (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 48/10) me të cilat është futur korniza ligjore për detyrimin e deklaratës doganore elektronike dhe për dorëzimin elektronik të informatave për njoftimin e mallrave gjatë nisjes dhe arritjes nga dhe në territorin doganor të Republikës së Maqedonisë, si kushte për funksionimin e sistemit të ri për përpunimin e deklaratave doganore dhe për përparimin e sistemit për kontroll doganor të bazuar në analizë të riskut. Me këtë është kryer edhe harmonizimi me Legjislacionin doganor të BE, Rregullores të Këshillit të BE nr. 2913/1992, si dhe ndryshimet dhe plotësimet të sjella me Rregulloret 82/97, 955/1999, 2700/2000, 648/2005 dhe 1791/2006.

Në fund të vitit 2010 Qeveria e Republikës Maqedonisë ka sjell Vendim për harmonizim dhe ndryshim të Tarifës Doganore për vitin 2011 (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 165/10), me të cilën tarifa doganore sipas detyrimeve të marra nga Ligji për ratifikimin e Protokollit për aderimin e Republikës së Maqedonisë në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe ndryshimet e nomenklaturës së kombinuar të BE (të publikuar në Gazetën zyrtare të BE nr. L 284 nga

Mes tjerash, me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit doganor është mundësuar doganimi i përbashkët me shërbimet doganore të vendeve fqinjë) është hequr koncepti “person për të cilin ekziston rrezik më i madh” dhe u transferuan dispozitat për përqindje të vetme doganore nga Ligji doganor në Ligjin për Tarifë doganore.



### I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPËJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË

29.10.2010) është harmonizuar. MFN përqindjet doganore janë zvogëluar në 27 norma tarifore. Ulje të përqindjeve doganore ka në krrerët 34 dhe 39 të Tarifës doganore në të cilën janë përfshirë sapun të lëngshëm, detergjente dhe disa prodhime nga materialet plastike si gypa, foli, etj. Përqindja doganore mesatare e përagrafave të lartpërmendur në vitin 2010 arrin 10,92%, ndërsa në vitin 2011 arrin 8,38%. Janë fshirë gjithsejtë 256 shenja tarifore ndërsa janë futur 123 shenja tarifore të reja për shkak zvogëlimit të vëllimit të tregtisë. Janë futur 22 shenja tarifore nacionale për arsye se në Nomenklaturën e Kombinuar – grupë i njëjti i prodhimeve janë përfshirë bashkarisht, ndërsa në tarifën tonë doganore ato janë me përqindje doganore të ndryshme dhe për atë arsye janë të ndara në nivel nacional (numri i nëntë dhe i dhjetë).

### LIDHJA DHE NDËRVEPRIMI ME SISTEMET INFORMATIKE TË BE

Drejtoria doganore në vitin 2010 ka vazhduar me përgatitjen e sistemit të ri për përpunimin e deklaratave doganore i cili duhet të zavendëson softverin ASYCUDA, të ofrojë bazë teknike për mjedis pa letër në punën doganore, si dhe përputhshmëri për lidhje me sistemt TIK të BE.

Në maj 2010 DG-TAXUD ka realizuar misionin monitorues TI të tretë në Drejtorinë doganore. Objektivi kryesor i misionit ishte ecuria e projekteve të tanishme dhe të potenciale të financuara në kuadër të programit IPA dhe shqyrtimi i projekt strategjisë për zhvillim të TIK në Drejtorinë doganore dhe Strategjisë për ndërveprim me sistemet doganore të BE. Në lidhje me aktivitetet konkrete, Misioni vëri në dukje përmirësimin e dukshëm në menaxhimin me sistemet TIK të Drejtorisë doganore, ndërsa për zbatimin e menaxhimit me proceset e pjesshme është theksuar se Drejtoria doganore është lider në regjion.

Në dhjetor 2010 Qeveria e Republikës Maqedonisë ka miratuar:

- Strategji për zhvillimin e teknologjisë informatike dhe komunikative,
- Strategji për zbatimin e ndërveprimit për aderimin te BE,
- Strategji për zbatimin e sistemit të përbashkët tranzit të BE dhe
- Plan nacional për zbatimin e projektit NCTS.

Këto strategji të përgatitura nga Drejtoria doganore me ndihmën e konsulentëve të angazhuar në kuadër të projektit IPA 2007, janë dokumente të nevojshme të cilët konfirmojnë angazhimin dhe përkushtimin e Qeverisë së Republikës Maqedonisë për plotësimin e kushteve për anëtarësim në BE. Strategjitë janë dorëzuar në Komisionin Evropian (Drejtorinë për dogana dhe tatim dhe Drejtorinë për zgjerim), ndërsa në fillim të vitit 2011 të njëjtat janë prezentuar para përfaqësuesve të Komisionit Evropian në Bruksel. Sipas analizave, Republika e Maqedonisë do të jetë gati për fillimin e negociatave për anëtarësim në konventën për tranzit të përbashkët në gjysmën e dytë të 2012, në bazë të së

Nëse Republika e Maqedonisë me sukses dhe me kohë i realizon strategjitë dhe planin projektues për implementimin e NCTS- mund të bëhet anëtare e Konventlës sëpërbashkët tranzite të BE, dhe me atë të siguroj edhe qasje te sistemet informatike evropiane edhe para se me u bë anëtare e BE.



### I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË

cilës do të inicohet procedurë për sigurimin me kohë të fondeve dhe kushteve për kyçjen në sistemet doganore TI përmes nyjes CCN/CSI.

Në kuadër të projekteve IPA 2008, bazuar në procedurat e kryera më parë, në fund të vitit 2010 janë lidhur marrëveshje për përgatitjen e softverit për ndërlidhjen me NCTS dhe për kontroll të kualitetit të softverit. Zbatimi i marrëveshjes ka filluar në shkurt 2011.

#### 2. Lehtësimet doganore dhe tatimore

Në bazë të vëzhgimit dhe analizave të situatës dhe mundësive, Qeveria e Republikës së Maqedonisë edhe në vitin 2010 ka vazhduar me sjelljen e masave për zvogëlimin e detyrimeve të lidhur me importin.

**Në janar 2010 janë miratuar ndryshimet e Ligjit për taksat administrative** ("Gazeta zyrtare e RM" nr.6/2010), ku janë hequr taksat administrative për:

- dorëzimin e deklaratës doganore,
- kërkesës për lëshimin e qertifikatës për qarkullim EUR 1,
- për dokumente të cilat janë përcaktuara me marrëveshjet ndërkombëtare ose ndërshtetërore, të pranuar ose të ratifikuara nga ana e Republikës së Maqedonisë të cilat përdoren në vend të deklaratës doganore dhe
- shënimit për futjen dhe nxerrjen e mallit në dhe nga zona e lirë ose depo të lirë.

Heqja e këtyre taksave administrative ka për qëllim zvogëlimin e shpenzimeve të operatorëve ekonomik dhe zvogëlimin e procedurave administrative, por edhe harmonizimin me standardet evropiane.

Në mars 2010 Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka sjellë një sërë masash me të cilat dukshëm janë zvogëluar shpenzimet për import të automobilave. Gjegjesisht, me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Tarifat doganore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 35/ 10) janë ulur përqindjet doganore të automobilave të përdorur dhe të ri. Me ndryshimet dhe plotësimet të Ligjit për akciza ("Gazeta zyrtare e RM nr. 34/10) vëllim i punës, si bazë për llogaritjen e akcizëve të automjeteve motorike është ndryshuar me vlerën e automjetit, ku automjeteve të pasagjerëve me vlerë doganore deri më 3000 euro detyrimet akcize janë zero. Në mars 2010 Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka miratuar ndryshime dhe plotësime të Rregullores për zbatimin e Ligjit doganor ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 38/10) me të cilat zbatimi i rregullave të lejuar për një import kumulativ gjashtëmuor të

Me ndryshimet dhe plotësimet të Ligjit për tarifë doganore janë hequr detyrimet doganore të dy normave doganore në të cilën janë përfshirë lëndë e parë- prodhime nga qeramika për qëllime teknike.

Në 2010 për import janë doganuar mbi 51 mijë automjete për pasagjerëve të përdorur, në krahasim me më pak prej 3 mijë të importuar të përdorur në vitin 2009.





### I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË

përkohëshëm të automjeteve me targa të huaja regjistrim është shtyrë deri më 30.09.2010.

Njëkohësisht, me qëllim mundësinë e doganimit importues dhe regjistrimin e automjeteve me targa të huaj në pronësi të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, standardi tekniki nevojshëm që duhet ta plotësojnë automjetet është EURO 1. Me ndryshime dhe plotësime të rregullores për miratim individual të automjeteve dhe Rregullores për identifikimin dhe vlerësimin e gjendjes teknike të automjetit në kuadër të ligjit për automjete, është hequr atesti për homologim si kusht për doganim importues të automjeteve.

Në mars 2010 Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka miratuar ndryshime dhe plotësime të Urdhërësës për kritere më të afërta dhe mënyrën e zbatimit të lirimit nga pagesa e detyrimeve importuese si dhe vlerën, sasinë dhe llojin ose dedikimin e mallit e cila mund të lirohet nga pagesa e detyrimeve doganore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 28/10), me të cilën vlera e sendeve të cilët udhëtarët vendas përreth bagazhit personal i importojnë nga jashtë rritet prej 175 në 350 euro nëse e njëjta nuk është e natyrës tregtare. Ndryshimet e sjella të kësaj urdhërese është në përputhje me Direktivat e Këshillit të BE 74/2007.

### 3. Thjeshtimi dhe përshpejtimi i procedurave doganore dhe tatimore

Pëveç lehtësimeve doganore dhe tatimore, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Drejtoria doganore në vitin 2010 kanë vazhduar me reformat sistematike për përshpejtimin dhe thjeshtimin e importit, eksportit dhe tranzitit, si me intervenime në rregulloren ashtu edhe me **thjeshtëzimin e procedurave dhe me futjen intenzive e sistemeve informatike për përkrahjen e E-dogana.**

#### Korniza juridike

Në dhjetor 2010 janë **miratuar ndryshime dhe plotësime të Ligjit doganor ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 158/10) me të cilën rregullohen kushtet dhe procedura për dhënien e lejeve për kryerjen e punëve të përfaqësimit në procedurat doganore (personave juridik) dhe licencave për kryerjen e përfaqësimit (personave fizik).** Janë përcaktuar kushtet për dhënien e provimit profesional për përfaqësues të licencuar dhe përmbajtja e provimit profesional, me fusha tematike, si dhe sanksione kundërvajtëse si dhe kritere për pezullimin e lejës dhe licencave për kryerjen e punëve të përfaqësimit në procedura doganore. Lejet dhe licencat për kryerjen e përfaqësimit i lëshon Drejtoria doganore sipas kritereve të caktuara.

Në vitin 2010 filloi me zbatimin e mundësisë ligjore për të paraqitur deklaratën me gojë për dërgesa komerciale me vlerë të vogël. Deklaratë me gojë ka përparësi të shumta si për organet doganore ashtu edhe për importuesit. Sidomos zbatimi praktik i deklaratë me gojë në njësitë doganore ku doganohet dërgesa më të vogla të cilat arrijnë me postë, me aeroplan ose në pikat kufitare. Me doganimin me gojë shpejtohen procedurat doganore dhe zvogëlohen shpenzimet e importuesve si për shembull shpenzimet për shpedituese, deponuese, për shërbimet e transportit etj.



## I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPËJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË

Në vitin 2010 ka filluar me zbatimin e procedurave doganore të thjeshtëzuara dhe gjatë doganimit të dërgesave të përgjithshme. Kjo realizohet përmes qendrave logjistike të cilat i kanë lejet nga Drejtoria doganore për thjeshtëzimin në tranzit (lejet për pranues dhe dërgues të autorizuar). Me zbatimin e procedurave të thjeshtëzuara mundësohet zbatimi i procedurave doganore në hapësirat e kompanisë, doganimi është i mundshëm 24/7 dhe nuk mvaret nga orari i punës në njësitë doganore, nuk kanë obligim për hyrje në терминалет doganore me çka ju shmangen kompensimeve të terminaleve dhe zvogëlimit të shpenzimeve shpedituese.

Ashtu si çdo vit, Drejtoria doganore ka përgatitur udhëzues për doganimin e mallrave për 2011. Udhëzuesi është në dizpozicion falës në faqen e internetit të Drejtorisë doganore. Udhëzuesi ka për qëllim lehtësimin e procedurës doganore të punënjësve doganor si dhe pjesëmarrësve tjerë në tregtinë ndërkombëtare. Përveç normave doganore MFN, në të janë përfshirë edhe norma preferenciale në pajtim me marrëveshjet për tregti të lirë, TVSH, akcizave dhe masave jotarifore të përcaktuara. Në të njëjtën kohë, si njoftim për përmbushjen e obligimeve të Republikës së Maqedonisë sipas Protokollit për aderim te Organizata Botërore e Trgetisë, Drejtoria doganore ka përgatitur Tarifë doganore për vitin 2010 në gjuhën Angleze – e cila përmes Ministrisë së Ekonomisë është dorëzuar te Organizata Botërore e Tregtisë. Në gjuhën Maqedone janë përkthyer amendamentet e komentuara të Sistemit të harmonizuar 2007, të cilët janë sjellë në gjysmën e parë të vitit 2010. Të njëjtët edhe në formë elektronike janë dorëzuar deri te OBD, sipas marrëveshjes me të drejtën e përkthimit dhe shtypjen e publikimit nga OBD.

### E\_Dogana

#### Është futur aplikimi elektronik për marrjen e lejeve për import për përpunim të brendshëm

importi për përpunim paraqet aktivitet të madh ekonomik në Republikën e Maqedonisë. Për shkak natyrës së punës shpesh kërkon përshtatje të shpesht drejt porosive nga partnerët e huaj, është shumë e rëndësishme shpejtësia e shpërndarjes dhe përpunimi dhe nxerrjes të këtij lloji të lejeve. Drejtoria doganore çdo vitë lëshon qindra leje të reja dhe ndryshime të lejeve të lëshuara më parë për procedurë doganore për import për përpunim të brendshëm. Në fillim të vitit 2010 Drejtoria doganore sjell web aplikacion për dorëzimin elektronik të kërkesës leje për import për përpunim të brendshëm. Nëpërmjet këtij aplikacioni, përveç formës me

поднес ново барање (Procedura za Odobrenie za UO@Metastorm BPM Server) - Metastorm BPM - W1...

Царинска управа на Република Македонија  
**CUSTOMS.GOV.MK**  
Customs Administration of the Republic of Macedonia

Filename	Size
----------	------

### Барање за Одобрение

За царински цели за

Број на Барање

Ова Одобрение се обновува од

1. Подносител на Барањето

Даночен број, назив и седиште на Подносителот на Барањето

Даночен број, назив и адреса на Производителот

Page 1 of 1

Даночен број	Назив	Адреса
--------------	-------	--------

Притиснете "Залони" за внес на Производител !

2. Барање за употреба

Систем на одложено плаќање

Систем на враќање давачки




I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË

letër, operatorët ekonomik mund edhe përmes faqes së internetit të Drejtorisë doganore ti dorëzojnë kërkesat e veta, të cilat në mënyrë të konsiderueshme zvogëlon kohën për administrimin dhe procesimin e tyre dhe ritet transparenca dhe ndjekja. Megjithatë forma në letër mbetet e detyrueshme deri në ndryshimet ligjore të cilat do të mundësojnë legjitimitet të dokumenteve elektronike. Në rrjedh është mbindërtimi i aplikacionit për nënshkrim digjital, detyrimi elektronik i importit dhe futjes së mundësisë për aplikimin elektronik dhe marrjes së lejeve për lloje tjera procedura doganore me efekt ekonomik. Në maj 2010 Drejtoria doganore vendosi udhëzim për punë me web aplikacionin për përpunimin e kërkesave për leje për import për përpunim të brendshëm, i cili përshkruan mënyrën e punës me web aplikacionin për dorëzimin e kërkesës për lëshimin e lejeve për import për përpunim të brendshëm, futjen e të dhënave në kërkesën për leje për import për përpunim të brendshëm dhe dokumentet shoqëruese nga domeni i jashtëm të nevojshme gjatë aplikimit për leje dhe dokumente të cilat vazhdimisht dërgohen për ndjekjen dhe kontrollin e përdorimit të lejes.

Internet portali për dorëzimin elektronik të kërkesave deri te Drejtoria doganore

Që nga viti 2010, Drejtoria doganore ju mundësoi kompanive dhe përdoruesve tjerë të prodorin internet portralin të EDMS për dorëzimin elektronik të kërkesave deri te Drejtoria doganore. Në këtë mënyrë, kompanitë përveç në formë me letër, nga hapësirat e tyre punuese mund edhe në mënyrë elektronike të aplikojnë deri te organet doganore kompetente, me çka e gjithë procedura për marrjen e lejeve të cilat i lëshon Drejtoria doganore bëhet më e efikase. Deri në miratimin e bazës përkatëse ligjore për dorëzimin e dokumenteve në mënyrë elektronike si dhe duke bërë të mundur përdorimin e nënshkrimit digjital, është e detyrueshme që dorëzimi i kërkesave të bëhet edhe në formë të letrës. Në rrjedh është futja e nënshkrimit digjital të kërkesave elektronike.



Puna me kërkesat elektronike është rregulluar me shumë akte interne të Drejtorisë

e-Барања			
<b>Ново е-Барање</b>			
Барање за привремено отстранување на стоки од ЦС:	<a href="#">Образец 0001.pdf</a>	Барање за прекувремена работа:	<a href="#">Образец 0002.pdf</a>
Барање за поедноставена постапка при увоз:	<a href="#">Образец 0003.pdf</a>	Барање за издавање одобрение за крајна употреба:	<a href="#">Образец 0004.pdf</a>
Барање за локално царинење при извоз:	<a href="#">Образец 0005.pdf</a>	Барање за локално царинење при увоз:	<a href="#">Образец 0006.pdf</a>
Барање за поедноставена постапка - Одобен извозник:	<a href="#">Образец 0007.pdf</a>	Барање за поедноставена постапка при извоз:	<a href="#">Образец 0008.pdf</a>
Барање за враќање или простување:	<a href="#">Образец 0009.pdf</a>	Барање за употреба на T1 гаранција :	<a href="#">Образец 0010.pdf</a>
Барање за издавање статус на овластен испраќач:	<a href="#">Образец 0011.pdf</a>	Барање за добивање на статус на овластен примач:	<a href="#">Образец 0012.pdf</a>


**I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË**

doganore:

- Në prill 2010 është sjell udhëzim për dorëzimin elektronik të kërkesave deri te Drejtoria doganore, me të cilin rregullohet mënyra në të cilën personat juridik dhe fizik mund të dorëzojnë shumë lloje të kërkesave përmes internet portalit të Drejtorisë doganore, në kuadër të (EDMS), si dhe udhëzim për përpunim arkivor e kërkesave elektronike, me të cilin rregullohet mënyra e përpunimit të kërkesave të pranuar nga palët përmes portalit të jashtëm të Drejtorisë doganore në kuadër të EDMS;
- Në maj 2010 janë sjellë rregullore dhe kushte për regjistrim në portalin për komunikim elektronik me Drejtorinë doganore, si dhe kërkesa standarde për regjistrim në portalin për komunikim elektronik me Drejtorinë doganore;
- Në maj 2010 është sjell udhëzim për dorëzimin e dokumenteve deri te përdoruesit përmes internet portalit, si dhe udhëzim administrator për punë me portalin për komunikim elektronik.

**Faza e dytë nga zhvillimi i sistemi njësportel për dhënien lejeve importuese dhe eksportuese dhe kuota tarifore – EXIM**

Në vitin 2010 ka filluar faza e dytë nga zhvillimi i EXIM, i cili përfshin: integrim dhe përgatitje për shkëmbimin e të dhënave me sistemin e ri për përgatitjen e deklaratave doganor, integrimi me TRACES like sistemi i Drejtorisë për veterinarin, futjen e modulit për leje transportuese dhe mundësi për këqyrje në regjistra dhe raporte, ndërsa është përgatitur procedurë alternative me letër.



Si rezultat i përparimit të Republikës së Maqedonisë në këtë fushë, Komisioni Evropian e ka përfshirë Republikën e Maqedonisë

Komisioni profesional i Odës ekonomike për teknologji informatike dhe teknologjike – MASIT, i dhuroi EXIM-it çmimin e parë për vitin 2009 për zgjidhje në sektorin publik në fushën e teknologjisë informatike dhe komunikative.

**I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPEJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË**

që të marrë pjesë në grupin punues për “Single Window”. Qëllimi i

grupit të punës ishte për të zhvilluar një specifikim funksional në të cilën do të definohej standardet bazë të përbashkëta të BE në këtë fushë. Në tetor 2010 në Drejtorinë doganore është mbajtur takimi i pestë i grupit punues ku është theksuar përparimi i dukshëm i Republikës Maqedonisë në këtë fushë dhe vendosi që EXIM të prezantohet në punëtori “Singel window- dritare për mundësi” e cila është mbajtur në Varshavë më 10 dhe 11 nëntor 2010, në organizim të Komisionit Evropian. Në bashkëpunim me OBD është përgatitur studim në të cilën promovohen përvojat e Republikës së Maqedonisë në zhvillimin e kapacitetit të Single Window. E njëjta duhet të publikohet si pjesë nga programi “Ndihmë për tregti” të OBT.

Име на дозволата	Издадени дозволи	
	2009	2010
Согласност пратката со храна, производи и материјали кои доаѓаат во контакт со храната да влезе на територијата на РМ	14,037	23,972
Согласност за царинење на предмети за општа употреба	3,883	6,891
Потврда за извршен органолептички преглед и земени моистри	1,636	5,406
Решение за упис/одбивање во регистар на Биро за метрологија при увоз	1,752	1,939
Потврда за сообразност на единечно прегледано возило	2,202	478
Одобрение за увоз на лекови	741	2,500
Ветеринарен влезен документ за производи од животинско потекло	1,282	3,010
Одобрение за увоз на медицински помагала	550	1,983
Дозвола за транспорт/транзит на опасни материји	204	815
Одобрение за увоз на опасни и други видови на хемикалии	223	712
Други дозволи	2,122	4,375
<b>Вкупно</b>	<b>28,632</b>	<b>52,081</b>

Përdorimi i EXIM shënon rritje me 52.081 leje importuese të lëshuara ku është për 82% më shumë nga viti 2009 kur ishin lëshuar 26.632 leje importuese. Në vitin 2010 përmes EXIM janë parashtruar 5.198 kërkesa për kuota tarifore. Në fund të vitit 2010 në EXIM ishin të regjistruar 595 përdorues nga sektori privat, sidomos kompani me leje për kryerjen e punëve të përfaqësimit doganor të cilët në EXIM kryejnë punë për mijëra klient të tyre.



## I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPËJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË

### 4. Akciza

Nga 01.01.2010 Drejtoria doganore nga Drejtoria për të hyra publike ka marrë udhëheqjen dhe grumbullimin e të gjitha llojeve të akcizave në territorin e Republikës së Maqedonisë. Përveç administrimit e dokumenteve akcize, ka filluar edhe analiza për

futjen e metodave të reja për hetime laboratorike, laborator mobile, kontrolla e normave për prodhimin e mallrave të akcizave, kriteret për analizë të rrezikut të kontrollit në terren dhe jashtë terrenit, mjete të reja për mbrojtjen preventive për grumbullimin e akcizave si dhe kompjuterizimin e proceseve.

Me ndryshimet e Rregullores për zbatimin e Ligjit për akciza (Gazeta zyrtare e RM” nr. 46/2010), ndryshohet paraqitja akcize për automobila të pasagjerëve, me çka është mundësuar llogaritja e akcizës në bazë të vlerës së automobilit, në vend të vëllimit të motorit.

Në qershor 2010 janë sjellë ndryshime dhe plotësime të rregullores për zbatimin e Ligjit për akciza (“Gazeta zyrtare e RM nr. 85/10) i cili parashikon:

- procedurë të thjeshtëzuar të administrimit të dokumenteve akcizë gjatë transportit të mallrave që i nënshtrohen akcizave në procedurë të mungesës së kushteve për bërjen e borxhit akcizë,
- pagesa e shpenzimeve për shtypje, transport, rruajtjen dhe dhënien e markave kontrolluese me paraqitjen e kërkesës për sasi të planifikuara të markave kontrolluese,
- dhënien e markave kontrolluese me kërkesë të poseduesit të lejes akcize ose importuesit një herë në javë, në vend dy herë në muaj,
- futjen e formulareve të reja të markave kontrolluese për shënimin e produkteve të ndërmjetme dhe atil alkoolit dhe formulare të markave kontrolluese për shënimin e mallrave të duhanit- të përpunuara me teknologji më bashkëkohore me qëllim mbrojtjen nga falsifikimi eventual i tyre.

Është mundësuar kontroll më efikas të vajrave minerale përmes ndryshimit të mjeteve për shënimin e të njëjtëve – ndryshime dhe plotësime të rregullores për zbatimin e Ligjit për akciza (“Gazeta zyrtare e RM” nr.156/2010).

Në vitin 2010 Drejtoria doganore ka përgatitur projekt për përpunimin e sistemit elektronik për kontrollin e akcizave i cili do të financohet nga programi IPA 2011. Projekti ka për qëllim përpunimin e sistemit për kontrollin e qarkullimit të mallrave akcizë, si dhe zhvillim dhe vendosjen e lidhjes me sisteme tjera, kompatible me sistemin kontrollues për qarkullimin e mallrave akcizë të BE. Me futjen e këtij sistemi, sipas standardeve të BE do të sigurohet përputhshmëri të plotë dhe ndërveprim me sistemit përkatëse doganore TIK të BE në këtë fushë.

Në bashkëpunim me Drejtorinë tatimore dhe doganore të Holandës, Drejtoria doganore në shtator 2010 ka organizuar trajnim për zbatimin e legjislacionit akcizë të BE,



**I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPËJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË**

grumbullimin e akcizave, llojet e akcizave, analiza krahasuese e legjislacionit maqedonas dhe atij të evropës dhe llojet e procedurave për zbatimin e tij. Trajnimi është realizuar në kuadër të Programit për ndihmë teknike në mes Drejtorisë doganore të RM dhe Drejtorisë doganore dhe tatimore të Holandës.

**5. Lejet dhe licencat doganore**

Në vitin 2010 Drejtoria doganore ka vendosur sipas kërkesave nga operatorët ekonomik për marrjen e licencave dhe lejeve për përfaqësim në procedurat doganore dhe për miratimin e procedurave specifike doganore.

**Për procedura të thjeshtëzuara doganore janë lëshuar gjithsejtë 94 leje me çka ka më shumë se dyfish rritje të përdorimit të procedurave të thjeshtëzuara doganore në krahasim me vitin 2009.** Rritje e caktuar është vërejtur edhe te lejet tjera aktive të cilat i lëshon Drejtoria doganore. Janë lëshuar 13 leje të reja për procedurë doganore import për

Lloji i lejes	2010	2009
Përfaqësimi doganor personat juridik	310	290
Përfaqësimi doganor licencat	883	750
Procedura me ndikim ekonomik	553	533
Procedura të thjeshtëzuara doganore	181	87
Eksportues i autorizuar	39	20

përpunim të brendshëm me sistem të pezullimit të pagesës, ndërsa për 350 leje është bërë ndryshimi i caktuar. Janë sjellë 2 leje të reja për procedurë doganore për përpunim të jashtëm, ndërsa për 6 është vazhduar afati i vlefshmërisë. Për procedurë doganore depopnim janë lëshuar 7 leje të reja, ndërsa për 39 leje të lëshuar më parë është bërë ndryshim. Në vitin 2010 janë pezulluar 2 leje për deponim doganor. Në vitin 2010 Drejtoria doganore ka lëshuar 21 leje për kryerjen e punëve të përfaqësimit të personave juridik dhe 133 licenca për përfaqësim të personave fizik. Të njëjtin vit është marrë 1 leje për përfaqësim në procedura doganore. Gjithashtu, janë kontraktuar 56 marrëveshje të reja për përdorimin e sistemit informativ doganor MAKCIS. Në vitin 2010 janë lëshuar 19 leje për eksportues të autorizuar dhe 97 informata tarifore të detyrueshme.

**6. Fushëveprimi i punës**

Në vitin 2010 Drejtoria doganore ka përpunuar 994 mijë ECD ku është për 18,08% më shumë në krahasim me vitin 2009. Në vitin 2010 janë përpunuar 418 mijë ECD tranziti, ku është për 15,55% më shumë në krahasim me vitin 2009, 207 mijë ECD eksportuese, ku është për 8% më shumë në krahasim me vitin 2009 dhe 368 mijë ECD importues ku për 27,97% është më shumë në krahasim me vitin 2009. Karakteristike për vitin 2010 është

Deklarata doganore	2009	2010	%
Tranzit	362,117	418,421	15,55
Import	287,607	368,063	27,97
Procedurë të rregullt	256,187	313,259	22,28
Procedurë të thjeshtëzuar	31,420	54,804	74,42
Eksport	191,697	207,028	8,00
Procedurë të rregullt	142,929	137,329	-3,92
Procedurë të thjeshtëzuar	48,768	69,699	42,92
<b>Gjithsejtë</b>	<b>841,421</b>	<b>993,512</b>	<b>18,08</b>



### I. LEHTËSIMI DHE PËRSHPËJTIMI I TRANSPORTIT DHE TREGTISË

ritja e konsiderueshme e interesit të operatorëve ekonomik për shfrytëzimin e procedurave të thjeshtëzuara me çka zvogëlohet koha dhe shpenzimet për zbatimin e procedurave doganore. Gjegjësisht, në vitin 2010 në procedura të thjeshtëzuara doganore janë përpunuar 125 mijë ECD ose 13,37% nga gjithsejt ECD të përpunuar, të krahasuar me 9,53% në vitin 2009. Nga gjithsejt ECD importuese të përpunuar në vitin 2010 14,89% janë realizuar në procedurë të thejshëzuar doganore, në krahasim me

10,92% në vitin 2009. Nga gjithsejtë ECD eksportuese të përpunuara në vitin 2010 në procedurë të thjeshtëzaur doganore janë realizuar 33,67%, në krahasim me vitin 2009 kur janë realizuar 25,44%. Kjo do të thotë se operatorët ekonomik më shumë i pranojnë procedurat doganore të cilat zbatohen në BE me çka zvogëlohet koha e pritjes dhe shpenzimeve për kryerjen e eksportit nga Republika e Maqedonisë.

Në vitin 2010 kufinjte në Republikën e Maqedonisë i kanë kaluar 867 mijë automjete transportuese, 3051 automobila të pasagjerëve (nga të cilat 122 mijë autobusa dhe 2929 mijë vetura), 245 mijë vagonë dhe 11.450 aeroplana.



## II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

Detyra kryesore e Drejtorisë doganore është zbatimi i kontrollit të zbatimit të ligjeve nga aspekti i grumbullimit të të ardhave buxhetore, parandalimi i tregtisë ilegale dhe konkurrencës jolojale, parandalimin e tregtisë me mallra të ndaluar dhe finacimit të terorizmit dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve dhe mbrojtjes të ambientit jetësor. Në vitin 2010 drejtoria doganore ka vazhduar ti përmirësoj kapacitetet e saj për kryerjen e detyrave të parashikuara ku kanë arritur edhe rezultate të rëndësishme.

### 7. Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve për analizën e rrezikut

Në kushte të rritjes permanente të tregtisë ndërkombëtare dhe numrit të transaksioneve, kontrolli doganor bazuar në analizë të rrezikut paraqet mjet thelbësor për selektimin e qëllimeve të cilat do të kontrollohen. Analiza e riskut mundëson përdorim racional dhe efikas të burimeve gjatë kryerjes së kontrolleve doganore, ndërsa nga ana tjetër nuk e mbingarkon dhe pengon zinxhirin e furnizimit të biznesit legal. Drejtoria doganore tashmë ka zhvilluar sisteme dhe zbaton kontroll doganor bazuar në analizë të rrezikut, ndërsa në vitin 2010 ka punuar për përparimin e mëtejshëm të kapaciteteve të saja në këtë fushë, siç është shpjegohet më poshtë.

Me qëllim adresimin me sukses me rreziqet gjatë kryerjes të kompetencave të veta, në fund të vitit 2010 Drejtoria doganore ka përgatitur Strategji për menaxhimin me rrezik 2011 – 2014. Strategjia parashikon përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit e shërbimit në tërësi dhe paraqet identifikimin sistematik dhe zbatimin e të gjitha masave të nevojshme për kufizimin e rrezikut.

Me qëllim që të sigurohet zbatim i Strategjisë për menaxhimin me rreziqet, si dhe monitorimin e zbatimit operativ të menaxhimit me rreziqet në kuadër të Drejtorisë doganore, në fund të vitit 2010 u vendos që të definohen kompetencat dhe të formohet një Komitet i veçant për menaxhimin me rrezik, ku mënyra e punës, si dhe të drejtat dhe obligimet e koordinatorit dhe anëtarëve, mënyra e punës dhe mënyra e kryerjes së punëve profesionale dhe administrative të lidhur me punën e Komitetit – të rregullohen me Rregullore për punë të Komitetit për menaxhim me rrezik.

Në tetor 2010 Drejtoria doganore ka sjell Doracak për punë me sistemin e porosive të Evropës Juglindore - SEMS<sup>1</sup>, me të cilën rregullohet mënyra e punës dhe procedurat standarde të punës me aplikacionin. SEMS shërben për shkëmbimin e informatave për pasagjerët, mallra dhe automjetet/ mjete lundruese/ aeroplanet dhe trafikut ajrore para arritjes së tyre, si dhe për mbledhjen dhe analizën e informacioneve të intelegjencës dhe analizës së rrezikut.


Me qëllim sigurimin e qasjes sistematike dhe uniforme në menaxhimin me rreziqet në njësitë doganore kufitare, vlerësim përkatës në menaxhimin me rrezik, si dhe zbatimin e kontrolleve të bazuar në analizë të rrezikut, në tetor 2010 është futur sistemi elektronik për menaxhimin me rrezik në pikat kufitare, i cili përfshin edhe qarkullimin jo-komercial. Në nëntor 2010 janë miratuar



**II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE**

ndryshime dhe plotësime të Udhëzimit për kryerjen e kontrollove selektive në punën doganore dhe është sjell Udhëzim për punë me modulën për menaxhimin me rrezik në njësitë doganore kufitare. Sistemi siguron të dhëna sistematike për rezultate nga kontrollet doganore të realizuara, analizën e të dhënave dhe përgatitjen e profileve të rrishtit.


Në nëntor 2010 ka filluar realizimi i fazës së dytë të projektit “Sistem për shkëmbimin elektronik të të dhënave (SEED) me vendet e Ballkanit Perendimor”, të financuar nga BE. SEED duhet të siguroj shkëmbim elektronik të të dhënave dhe kryerjen e tranzitit në mes vendeve të Ballkanit Perendimor, me çka do të sigurohet një shkall më të lartë të kontrollit doganor dhe reduktimin e krimit dhe



korupsionit doganor, si dhe eliminimin e shkarkimit aktual me dorë të tranzitit. Për zbatimin operativ të versionit ekzistues të aplikacionit në tetor 2010 është sjell Doracak për punë me SEED si dhe udhëzim për punë me aplikacionin për shkëmbimin sistematik të të dhënave SEED, me të cilin rregullohet mënyra e punës dhe procedurat standarde në shkëmbimin e të dhënave. Udhëzimi është dorëzuar deri te shërbimet doganore të shtetve fqinjë për informimin e tyre dhe përdorim të mëtejshëm. Në shtator dhe dhjetor 2010 Drejtoria doganore e RM me drejtoritë doganore të Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë kanë nënshkruar Protokolle dypalësh për shkëmbimin elektronik të të dhënave doganore përmes SEED.

Në vitin 2010 ka përfunduar projekti vlerësimi i rrezikut për dogant e Ballkanit perendimor - **RACWeB<sup>1</sup>**, të zhvilluar në bashkëpunim dhe me financim nga ana e BE. Sistemi ka për qëllim që ta rrit efikasitetin dhe transparencën e shteteve nga Ballkani perendimor në vlerësimin e rrezikut, përmes sigurimit të përkrahjes gjatë identifikimit të rrezikut me zbatimin e teknikave të kërkimit në bazat e të dhënave, në nivel nacional dhe regjional. Në rrjedh është përgatitja e akteve interne për vendosjen e softverit në funksion në nivel nacional.

Në bashkëpunim me Qeverinë e SHBA, në fazën përfundimtare është instalimi e sitemit elektronik për licencim, evidentimin dhe analizimin e rrezikut të mallrave me përdorim të dyfishtë **TRACKER**. Të dhënat në sistem duhet ti azhurojnë parasegjithash





## II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

Ministria e mbrojtjes dhe Ministria e ekonomisë. Në përgatitje është regullorja për punë me sistemin i cili duhet të miratohet nga ana e Qeverisë.

Në vitin 2010, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka sjell eleborat për vendosjen e sistemit të vetë të intergruar elektronik për menagjimin me rrezik – SAR në të cilin do të përfshihen të gjitha institucionet të cilat kryejnë mbikëqyrje inspektuese gjatë importit dhe tranzitit të mallrave. SAR do të mundëson përpunimin elektronik të kritereve për analizë të rrezikut të të gjithë organeve inspektuese në të njëjtën kohë, gjatë të dhënave të para për hyrjen dhe tranzitin e mallrave në sistemin elektronik për përpunimin e deklaratave doganore. Njëkohësisht, SAR do ta përshejton procedurën e zbatimit e formaliteteve të nevojshme në vendkalimet kufitare dhe do të krijoj kushte për kryerjen e të ashtuquajturit “One Stop Shop” kontroll në një vend, nga ana e të gjitha institucioneve të cilët kryejnë mbikëqyrje inspektuese. Shkëmbimi i informatave të nevojshme ndërmjet organeve kompetente në momentin e duhur, do të mundëson rritje të efikasitetit gjatë selektimit të qëllimeve të vërteta. Në rrjedh është definimi e proceseve punuese të organeve inspektuese të lidhur me analizën e rrezikut dhe përgatitjen e specifikimit funksional.

Për koordinim më efikas të mbikëqyrjes së tregut dhe lehtësimit të shkëmbimit të të dhënave dhe informatave, Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 2010 ka formuar trup koordinues për mbikëqyrjen e tregut, të përbërë nga anëtarët të organeve kompetente për mbikëqyrje inspektuese dhe nga Drejtoria doganore.

### 8. Forcimi i mëtejshëm i kapacitetit për kryerjen e kontrolleve doganore dhe hetimit

Në gusht 2010 Drejtoria doganore ka sjell Udhëzim për kontroll plotësues të dokumenteve për përcaktimin e vlerës doganore, me të cilin rregullohet mënyra dhe procedura për kontroll plotësues të dokumenteve relevante për përcaktimin e vlerës doganore të mallit, si dhe detyrimet e degëve organizative kompetente për mbajtjen e evidencës dhe dorëzimit të informatave lidhur me kompanitë për të cilët ka filluar procedura për kontroll plotësues të dokumenteve për përcaktimin e vlerës doganore. Njëkohësisht, është përgatitur edhe Udhëzim për veprim gjatë zbulimit të faturave dyjësi me të cilën rregullohet mënyra e veprimit gjatë zbulimit e faturave të dyfishta gjatë kontrollit të mallrave, dërgesave postare dhe automjeteve transportuese.

Në janar 2010 **Drejtoria doganore publikoi Kompendiumin për vlerë doganore dhe Komentin e sistemit të harmonizuar 2007 të OBD, në gjuhën maqedone.** Këtu publikime përmbajnë informata kryesore dhe shembuj praktik për përcaktimin e vlerës doganore dhe zbatimin praktik të sistemit të harmonizuar dhe paraqesin mjet funksional për lehtësimin e punës së përditshme të punënjësve doganor dh ezbatimin të drejtë të ligjeve.

Me qëllim rregullimin e mënyrës së procesimit të kategorive të reja të futura të

Kompendiumi për vlerë doganore përmban tërë tekstin të “Marrëveshjes për zbatimin e nenit VII” NGA “Marrëveshja e përgjithshme për doganë dhe tregti 1994” informata bazë dhe shembuj praktik për përcaktimin e vlerës doganore.

Komenti i sistemit të harmonizuar 2007 në 5 libra përmban tekstet oficiale nga botimi i katërt i fundit “Komenti i konventës për sistemin e harmonizuar për emrat dhe shifrat e mallrave” të OBD nga viti 2007 .

## II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

thirjeve në përputhje me ditarin elektronik të ri për aktivitete ditore të Departamentit për koordinim dhe komunikim (DKK), në gusht 2010 Drejtoria doganore ka sjell udhëzim të ri për punë të DKK. Udhëzim i ri për punë të DKK është plotësisht i harmonizuar me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, të vërtetuar me udhëzim të ri për punë me CCTV të sjell në mars 2010.

Funksionimi i pavarur i ekipeve mobile si mbështetje të njësive tjera organizative të Drejtorisë doganore është rregulluar me Udhëzim për punë të shërbimit për ekipet mobile, të sjellë në nëntor 2010. Në qershor 2010 është miratuar program i ri për mbrojtje nga rrezatimi i sitemit mobil – skaner rentgen, me të cilën vendoset sistem për mbrojtje nga rrezatimi, gjegjësisht implementohen standarde për mbrojtjen e njerëzve nga efektet dëmtoese të rrezatimit jonizuese, si dhe përforcohet kultura e sigurisë gjatë përdorimit të rrezatimit jonizues në qëllimet të dobishme. Organizimi i punës, mënyra e veprimit, përdorimi dhe rruajtje e rentgeneve mobil për kontrollin e bagazhit personal është rregulluar me Udhëzim për skanimin e bagazhit personal të udhëtarëve me rentgen mobil të miratuar në nëntor 2010 dhe doracak për punë me skaner mobil, i cili paraqet mjet informativ për të gjitha sistem operatorët të LS 207 sistemi Autovan, i cili mundëson përdorim të drejtë, sigurtë dhe efikas. Kapaciteti i ekipeve doganore për zbulimin e mjeteve narkotike është rritur plotësisht me 7 automobila të pajisuar special për transportin e qenjve doganor, të siguruar përmes projektit “Ndihmë teknike për përforcimin e kontrollit kufitar” në kuadër të projekteve IPA 2007.

Përmes projektit të njëjtë janë siguruar edhe 6 detektor elektronik të sofistikuar për narkotikë dhe eksploziv.

### 9. Laboratoria doganore

Në përputhje me kërkesat ISO 17025 standardet laboratoria doganore është përqëndruar në përgatitjen e mostrave dhe futjen e metodave të reja për analizën e mostrave dhe renditjen e mallrave sipas tarifës doganore. Në vitin 2010 janë futur metoda për analizën e derivateve të naftës dhe ngjyrës në vajrat minerale për amvisëri me hromatografi të lëngshme, metodën për caktimin e ngjyrosjes dhe markerit në karburante UV spektrometrike, metodën për analizën e jodit në kryp dhe metoda për përmbejtjen e krypës në mish dhe prodhime mishtore.



Gjatë vitit 2010 në laboratorinë doganore janë analizuar 247 mostra nga të cilat pjesa më e madhe janë derivate të naftës dhe supstite të qumështit ose emitime të prodhimeve qumështore. Në bazë të analizave të mostrave të marra nga rezervuari i automjeteve është konstatuar se në karburantet është i pranishëm shënues që tregon

**II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE**

se në automjetet motorike përdoret karburante për amvisëri me çka është tentuar që të shmangen detyrimet akcize më të larta.

**10. Rezultate nga mbikëqyrja dhe kontrolli doganor****Parandalimi i kontrabandës dhe malli i sekuestruar përkohësisht**

Në vitin 2010 Departamenti për punë operative ka kryer kontrolle detale në 3 mijë automjete transportuese, 2 mijë autobus, 1,7 mijë automobila të pasagjerëve, 31 trena dhe 43 individëve pa automjete. Bashkë me kontrollet nëpër kufinj dhe në degët doganore të mbrendshme, për shkak tentimeve të konstatuara për import apo tranzit të paligjshëm, përkohësisht janë sekuestruar sasi të madhe të madhrave të ndryshëm, nga të cilat më karakteristike janë



Prodhime tekstili dhe këpucë:  
53 mijë copë



barna dhe pajisje medicinale:  
382 mijë copë



Automobila dhe pajisje tjera:  
8 mijë copë



prodhime kozmetike:  
13 mijë copë

II. KONTROLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE



Cigare dhe pajisje :  
353 mijë copë



Profila aluminiumi:  
18 mijë kg



Ushqim dhe pije:  
32 mijë kg



Pajisje për amvisëri:  
19 mijë copë



Lule të freskëta dhe bimë:  
5 mijë copë



Audio dhe video pajisje dhe telefona:  
11 mijë copë



Arri dhe stoli :  
3,4 kg



Bizhuteri:  
17 mijë copë

II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE




naftë të kuqe dhe mazut:  
2,5 mijë kg



Materiale të ndryshme:  
70 mijë copë




Pajisje për shkolla dhe zyra:  
10 mijë copë



Oksigjen të lëngshëm:  
1,5 mijë kg

Si rezultat i masave sistematike për forcimin e kontrolleve doganore dhe ndalimin e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, sipas vlerësimeve të prodhuesve dhe importuesve të prodhimeve të duhanit, **pjesëmarrja e cigareve në të cilat nuk janë paguar detyrimet në konsumin e përgjithshëm të cigareve në Republikën e Maqedonisë, shënon**



**II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE**

rreñie permanente rreth 25% në fillim të vitit 2006 dhe rreth 6% në fund të vitit 2010.

**Parandalimi i tregtisë me narkotikë dhe materieve psikotrope**

Gjatë vitit 2010 Drejtoria doganore ka vazhduar me përmirësimin e kapaciteteve të saj dhe bashkëpunimin me institucionet vendase dhe të huaj, parasëgjithash me MPB, për parandalimin e tregtisë së paligjshme me narkotikë dhe materie psikotrope, e cila ka rezultuar me zbulime konkrete dhe konfiskime, ndër të cilat më karakteristike janë përshkruar më poshtë. .



Në vendkalimin kufitar Tabanovc, në një automobil të pasagjerëve me targa të Maqedonisë, i cili është paraqitur për dalje nga vendi, në pjesën e pasme të veturës janë zbuluar 2 kg heroin. Në vendkalimin kufitar Dellçevë, në një automobil të pasagjerëve me targa të Maqedonisë, i cili është paraqitur për hyrje në vend, nën parakolp në bunker të bërë special janë zbuluar 2 kg heroin. Në vendkalimin kufitar Deve Bair, në autobus me targa të Turqisë i cili është paraqitur për dalje nga vendi në kariget e fundit dhe të parafundit janë zbuluar 64 copë tableta akstaza. Në vendkalimin kufitar Bllacë gjatë kontrollit të brendshëm të autobusit janë zbuluar dhe konfiskuar 2 pako me heroin dhe peshë prej 1.015 gramë.

**Transferim i paligjshëm i parave**


Drejtoria doganore në vitin 2010 në shumë raste ka zbuluar tentime për futjen dhe nxerrjen e monedhave të huaj të padeklaruar mbi maksimumin e lejuar, me ç'rast përkohësisht ka sekuestruar para të ndryshme të huaj, ndër tjerash edhe 115 mijë euro dhe 156 mijë franga zvicerane.





**II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE****Parandalimi i emigracionit të paligjshëm**

Në vitin 2010 Drejtoria doganore në 2 raste, qershor dhe gusht, me ndihmë të skanerëve mobil janë zbuluar 3 persona migrant pa dokumente personal.



Në vendkalimin kufitar Bogorodicë në terminalin në mes të automjeteve transportuese të parkuara është zbuluar një person- migrant pa dokumente personale. Në vendkalimin kufitar Bllacë në dalje nga vendi në një kamion me targa të maqedonisë janë zbuluar dy persona-migrant pa dokumente personale.

**Zbulohet nivel i lartë i rrezatimit jonizues**

Në vitin 2010, në 4 raste Drejtoria doganore gjatë hyrjes në Republikën e Maqedonisë ka konstatuar nivel të lartë të rrezatimit jonizues. Në bashkëpunim me Drejtorinë për siguri radiacioni, saktë është konstatuar niveli dhe burimi i rrezatimit jonizues dhe janë sjellë masa për largimin e pasojave negative.

**Operacione ndërkombëtare**

Në vitin 2010 Drejtoria doganore ka marrë pjesë, ka koordinuar dhe organizuar në nivel ndërkombëtar 8 operacione ndërkombëtare: AUNT për monitoring të sasive të vogla të cigareve prej 2000 deri më 100.000 copë nga Evropa Lindore dhe Jugore, SHADOW IV i fokusuar në transportin legal dhe jolegal të cigareve dhe duhanit të thatë përmes vendeve të Evropës Juglindore, MOUSETRAP i fokusuar në kontrollin e dërgesave postare të lidhur me shitjen në internet, MERCURY II i fokusuar në kontrollin e dërgesave postare të prodhimeve farmaceutike të porositur përmes Internetit dhe GLOBAL SHIELD i fokusuar në shkëmbimin e informatave në mes vendeve pjesëmarrëse për importet ligjore, eksportet, tranzitin dhe tregtisë me rrezik të madh të kemikaljeve. Bashkëpunimi është intenzivuar me RILO në kuadër të WCO me futjen e të dhënave në bazën CEN të të dhënave, ka vazhduar bashkëpunimi me ZKA Ballkan Info për shkëmbimin e të dhënave për konfiskimin e drogës dhe të dhënave për kontrabandë potenciale të drogës.

**11. Mbrojtja e të drejtave nga pronësia intelektuale**

Në fund të vitit 2010 Drejtoria doganore ka përgatitur Strategji për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale 2011-2013. Strategjia synon përmirësimin e strukturës organizative dhe pajisjeve teknike të Drejtorisë doganore, trajnim të vazhdueshëm të nëpunësve doganor, ngritjen e vetëdijes për pasojat e dëmshme nga


**II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE**

mali i falsifikuar dhe mbrojtja e konkurrencës të prodhimeve vendas dhe të huaj të mallrave me marka të mbrojtura. Në fund të vitit 2010 në Drejtorinë doganore janë

regjistruar 223 kërkesa të markave tregtare për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale.

**Rezultate**

Drejtoria doganore në vitin 2010 ka intervenuar në 131 raste për shkak dyshimit se janë shkelur të drejtat nga pronësia intelektuale në procedurë të importit, eksportit, tranzitit të mallrave dhe procedurës së deponimit doganor (krahasuar me 130 në vitin 2009). Në bazë të aksioneve të realizuara përkohësisht janë sekuestruar 372.225 copë, dhe 400 metra mallra për të cilat ekzistonte dyshimi se shkelin të drejtat nga pronësia intelektuale nga të cilat më karakteristike janë:



CD të zbrazta: 55,1 mijë copë



prodhime tekstili: 24,5 mijë copë



Etiketa : 20 mijë copë dhe 400 metra



këpucë sportive: 18 mijë pale


II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE



syza për diell dhe galenteri prej lëkure : 13,3 mijë copë



Autopjesë : 9,3 mijë copë



Kozmetikë dhe parfimeri: 7 mijë copë



M  
telefona celularë dhe statik dhe pajisje: 2,4 mijë copë



Audio/video pleer dhe pajisje:  
2,6 mijë copë



Mallra tjerë : 220 mijë copë

Sipas Ligjit për masa doganore për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale, pas përfundimit të procedurës për vërtetimin e falsifikimit dhe shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale, Drejtoria doganore në 2010 ju ndihmonte mbajtësve të markave tregtare në zbatimin e procedurave për asgjësimin e 56 mijë copë mallra të falsifikuar.



### II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

#### 12. Kontrollat dhe hetimet

##### Kontrolli i kompanive

Kontrolli i kontabilitetit dhe dokumentacionit financiar zë një pjesë të madhe në funksionet e kontrollit të plotë të Drejtorisë doganore, ku në vitin 2010 janë zbuluar një numër i madhe i parregullsive nga aspekti doganor. Në vitin 2010 janë zbatuar 147 kontrolle të kompanive dhe 321 kontrolle të poseduesve të lejeve për import për përpunim të brendshëm dhe deponim doganor. Në bazë të kontrolleve janë sjellë 562 vendime për arkëtim plotësues të 29,373 milion denarë në emër barxhit doganor dhe akcizë. Në 2010 janë kryer 67 kontrolle të jashtme të poseduesve të lejeve akcize dhe kërkesë për kthimin e akcizave, ku është imponuar grumbullimi plotësues i mbi 3 milion denarëve borxh tatimor dhe janë marrë 3 leje akcize.

Në bazë të kontrolleve të bazuar në sistemin për analizë të rrezikut në vitin 2010 janë llogaritur dhe mbledhur plotësisht rreth 21,4 milion euro, në krahasim me vitin 2009 kur plotësisht janë grumbulluar rreth 11 milion euro.

##### Kontrollimi i dokumenteve doganore

Deri te shërbimet doganore të shteteve tjera janë dërguar 98 kërkesa për kontroll të vlerës (395 në 2009) dhe 443 kërkesa për kontroll të dëshmive për origjinë (203 në vitin 2009). Në vitin 2010 janë sjellë gjithsejtë 417 vendime për grumbullimin plotësues të borxhit doganor në bazë të kontrollit të faturave, ku është llogaritur dhe vendosur borxh plotësues në shumë prej rreth 2,4 milion euro. Në bazë të kontrollit të dëshmive për origjinë janë sjellë 158 vendime me të cilat është përlogaritur borxh plotësues në shumë prej rreth 252 mijë euro.

##### Kundërvajtjet doganore

Në 2010 deri te Komisioni për kundërvajtje pranë Drejtorisë doganore janë parashtruar 1.184 kërkesa për fillimin e procedurës penale (1.499 në 2009), nga të cilat: 1.114 kërkesa të dorëzuara nga njësitë organizative të Drejtorisë doganore, 50 kërkesa nga MPB, 13 kërkesa nga gjykatat themelore dhe 7 kërkesa nga inspektorati shtetëror i tregut. Komisioni për kundërvajtje pranë Drejtorisë doganore në periudhën 2010 ka zgjidhur 1.342 lëndë ku janë shqiptuar gjoba në shumë prej 1,2 milion euro.

Nga fillimi i vitit 2010, Drejtoria doganore është kompetente për vendosjen sipas kundërvajtjeve të paraparë në Ligjin për akciza. Në vitin 2010 janë pranuar 22 lëndë për bëerjen e kundërvajtjeve akcize, nga të cilat 14 kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtës të parashtruara nga Inspektorati Shtetëror i Tregut, në 7 kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtës parashtrues është Drejtoria doganore dhe në një kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtës është MPB.

**II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE****Vepra penale**

Bazuar në hetimet e kryera, Drejtoria doganore në vitin 2010 deri te Prokuroritë publike ka ngritur 105 kallëzime penale kundër 67 kompanive dhe 128 personave fizik

(në 2009 janë ngritur 123 kallëzime penale, kundër 49 subjekteve dhe 147 personave fizik). Një numër i madh i kallëzimeve penale kanë të bëjnë me kryerjen e veprës penale mashtrim doganor, kontrabandë dhe prodhim i paautorizuar të narkotikëve dhe tregtisë.

Кривично дело	2009	2010
Кражба		1
Криумчарење	26	16
Недозволена изработка, чување и тргув.со оружје	2	
Неовластено производство и промет со наркотици	4	8
Промет со акцизни стоки без бандероли	28	
Транспорт со акцизни стоки од акциз.склад	5	2
Фалсификување и употреба на исправа	4	2
Царинска измама	44	62
Недозволена трговија	1	
Производство и пуштање во промет штетни средства за лекување	3	3
Фалсификување на знаци за вредност	2	4
Криумчарење мигранти	2	
Изнесување и извезување во странство на добра под привремена заштита или	1	
Неовластено производство и промет со општо опасни материи	1	4
Прикривање на стоки кои се предмет на криумчарење и царинска измама		3
<b>Вкупно</b>	<b>123</b>	<b>105</b>

**13. Detyrimet e mbledhura importuese**

Në vitin 2010, Drejtoria doganore ka mbledhur gjithsejtë 41 miliardë denarë në emër të të dhënave buxhetore, ku është për 5% më shumë në krahasim me vitin 2009.

**Dogana dhe të dhënat doganore**



## II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

Nga gjithsejtë të ardhurat e mbledhura buxhetore sipas llojeve, në emër të doganës dhe të dhënave doganore, në vitin 2010 janë mbledhur 4.760 milion denarë ku është për 12% më pak në krahasim të realizimit në periudhën e njëjtë 2009. Krahasuar me të ardhurat

e planifikuara për periudhën janar-dhjetor 2010 të cilat ishin 5.709 milion denarë, janë

Назив на главата	2009	2010	Разлика
Месо и други кланични производи за јадење	774	687	-87
Шеќер и производи од шеќер	218	30	-188
Облека и прибор за облека, освен плетени или хеклани производи	205	132	-74
Производи од железо или челик	136	94	-42
Возила, освен железнички или трамвајски шински возила	558	741	183
Воздухоплови, космички летала и нивни делови	228	0	-228
Друго	3,290	3,076	214
<b>Вкупно</b>	<b>5,410</b>	<b>4,760</b>	<b>-649</b>

realizuar 83% të të ardhurave të planifikuara.

Zvogëlimi i mbledhjes së detyrimeve doganore në vitin 2010 ka të bëjë me uljen e vëllimit të importit. Ulje më të madhe ka në mbledhjen e detyrimeve doganore nga Kreu 88 nga tarifa doganore. Kjo ka të bëjë me faktin se në vitin 2009 janë importuar helikopter, të cilat kanë vlerë të madhe dhe kanë pasur ndikim të madh në grumbullimin e të dhënave doganore në vitin 2009. Ndikim të dytë të rëndësishëm në reduktimin e grumbullimit të të dhënave doganore ka edhe imoprti i sheqerit me origjinë preferenciale nga Serbia në vitin 2010, ku për shkak normsë doganore zero, në mënyrë drastike është reduktuar mbledhja e të dhënave doganore nga ky lloj i mallit në vitin 2010 në krahasim të vitit 2009 kur importi ishte kryesisht për sheqer pa origjinë preferenciale dhe normë doganore prej 30%. Ndikim në reduktimin e mbledhjes të të dhënave doganore në vitin 2010 ka edhe në mbledhjen e detyrimeve doganore të mallrave nga Kreu 2 të tarifës doganore, gjegjësisht mishit dhe prodhimeve tjera mishtore për ushqim. Reduktimi ka të bëjë me vëllimin e vogël të importit veçanarisht të mishit të ngrirë prej lope dhe derri. Reduktim të madh të mbledhjes së detyrimeve doganore në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009 ka te veshjet. Edhe për shkak vëllimit të rritur të importit edhe nga sasia edhe nga vlera reduktimi i të dhënave ka të bëjë me uljen e normës doganore për rketë lloj të mallit prej 25% në 17,5%, ndërsa pjesërisht edhe në reduktimin e normës preferenciale. Reduktim ka edhe te normat preferenciale nga BE tejk disa nga këto mallra tek të cilat norma preferenciale është zvogëluar për 50%. Zvogëlim të të ardhurave nga të dhënat doganore ka edhe te prodhimet nga Kreu 34 gjegjësisht, sapunat, preparatet larëse, preparatet lubrifikuese, dyllat artificiale, dyllat e përgatitur dhe preparatet lustruese. Zvogëlimi i të dhënave ka të bëjë me zvogëlimin e normës doganore te sapunat dhe preparatet larëse, ndërsa



### II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

njëkohësisht edhe zvogëlim të normave doganor nga BE nga ku ka edhe vëllim më të madh të importit të këtyre prodhimeve.

Rritje të konsiderueshme të mbledhjes së detyrimeve doganore, vërehet te duhani dhe prodhimet nga duhani në vitin 2010 në krahasim të 2009. Ajo ka të bëjë me vëllimin e rritur të importit të prodhimeve nga Kreu 24 nga tarifa doganore. Në vitin 2009 janë importuar 3.669 tonë, ndërsa në vitin 2010 gjithsejtë 5.294 tonë prodhime të këtilla. Rritje më të madhe të vëllimit të importit ka te duhsni i thatë (lloji Prilep dhe Jaka) dhe tjetër të thatë hapësinor jooriental, si dhe te cigaret.

#### **Të ardhurat e mbledhura nga TVSH**

Të ardhurat e mbledhura nga TVSH në vitin 2010 arrin 34.814 milion denarë, ku është për 7% më shumë nga ajo e realizuar në vitin 2009 kur janë mbledhur 32.511 milion denarë. Krahasuar me të ardhurat e planifikuara të cilat në vitin 2010 aritën 31.349 milion denarë, janë realizuar 11% më shumë të ardhura nga ajo e planifikuar.

Rritje më të madhe ka në mbledhjen e TVSH për minerale, lëndve djegëse minerale naftë dhe derivate naftë, hekur, çelik dhe makinave. Ajo ka të bëjë me faktin se në vitin 2010 në mënyrë drastike është rritur importi i makinave dhe importi i hekurit dhe

çelikut në krahasim me vitin 2009. Rritje të madhe të mbledhjes nga TVSH ka te mineralet ku vëllimi i importit të mineraleve të nikelit dhe koncentratave është zvogëluar, por për shkak çmimit të lartë të bursës të nikelit, mbledhja e TVSH është rritur në krahasim me vitin 2009. Gjithashtu në këtë kre është shënuar rritje të minerelave të hekurit dhe koncentrateve të cilat në krahasim me vitin 2009 janë rritur edhe sipas vëllimit edhe sipas vlerës. Rritje të madhe të mbledhjes nga TVSH ka edhe te nafta dhe derivatet e naftës ku vëllimi i importit është zvogëluar, por për shkak rritjes së çmimit të bursës të prodhimeve nga këto kre, është rritur edhe mbledhja e të dhënave importuese për TVSH në krahasim me vitin 2009. Në vitin 2009 çmimi mesatar i naftës së papërpunuar arriti 62,28 USD për barel, ndërsa në vitin 2010 çmimi mesatar i naftës së papërpunuar arriti 79,68, USD për barel. Rritje nga mbledhja e TVSH ka edhe në kreun 52 (pamuk dhe prodhime nga pamuku) nga Tarifa doganore ku është rritur vëllimi i importit të pëlhurës nga pamuku. Rritja e mbledhjes ka të bëjë edhe me rritjen e çmimit të berzës së pamukut. Rritje është shënuar edhe në kreun 24 (duhan dhe prodhime duhani) nga Tarifa doganore ku është rritur vëllimi i importit në krahasim me vitin 2009. Në kreun 17 (sheqer dhe prodhime sheqeri) nga Tarifa doganore shënohet rritje nga mbledhja e TVSH për shkak vëllimit të rritur të importit të sheqerit dhe prodhimeve nga sheqeri, por më së shumti ka të bëjë me çmimin e rritur të berzës së sheqerit si bazë përbërëse për prodhimin e prodhimeve konditore.

#### **Të ardhurat e mbledhura nga akcizat**

Të ardhurat e përgjithshme nga akcizat në vitin 2010 arrin 14.670 milion denar, ndërsa në vitin 2009 arrin 14.730 milion denarë, që paraqet ulje prej 0,4%. Të ardhurat akcize nga importi në vitin 2010 arrin 934 milion denarë, ku në krahasim me 2009 paraqet



### II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

rritje prej 5%. Në krahasim me të ardhurat e planifikuara për vitin 2010 të cilat arrin 1.098 milion denarë, janë realizuar 85% të ardhura nga ajo e planifikuar. Të ardhurat

akcize në qarkullimin e brendshëm në vitin 2010 arrin 13.735 milion denarë, ku në krahasim me vitin 2009 të cilat arrin 13.844 milion denarë, paraqet rritje prej 0,79%. Megjithatë, në mbledhjen e akcizave për vitin 2010 ekziston rritje gjegjësisht ulje të të ardhurave të realizuar në krahasim me vitin 2009 në varfshmëri nga mallrat akcize. Të ardhurat e përgjithshme akcize nga alkooli, pijet alkoolike dhe birrës, në vitin 2010 arrin 1.092 milion denarë, ndërsa në vitin 2009 kanë qenë 1.164 milion denarë, e cila do të thotë zvogëlim për 6,24%. Te alkooli dhe pijet alkoolike është shënuar ulje të sasisë së mallrave akcizë të fituar nga prodhimi vendas. Akcizat e mbledhura për vitin 2010 për 864 mijë litra, krahasuar me mbledhjen për vitin 2009 932 mijë litra, paraqet ulje për 7,27%. Gjithashtu në vitin 2010 është zvogëluar edhe numri markave kontrolluese të lëshuara për 60.600 copë në krahasim me vitin 2009. në vitin 2010 gjithsejtë janë lëshuar dhe mbledhur 1.189.200 marka kontrolluese, ku në krahasim me vitin 2009 në të cilën janë lëshuar dhe mbledhur 1.249.800 marka kontrolli, paraqet zvogëlim për 4,85%. Te pijet alkoolike nga importi, në vitin 2010 janë mbledhur akciza për sasinë e alkoolit dhe pijeve alkoolike prej 1.555.596 litra, ndërsa në vitin 2009 akcizat e mbledhura sipas sasisë prej 1.555.962 litra, që paraqet ulje për 11.366 litra, gjegjësisht 0,73%. Numri i markave kontrolluese të lëshuara për pije alkoolike nga importi në 2010 është 2.228.600 marka kontrolli, ndërsa në vitin 2009 janë lëshuar 2.176.200, që paraqet rritje për 2,41%. Akcizat e mbledhura nga importimi i birrës në vitin 2010 arrin 68,86 milion denarë, ku në krahasim me vitin 2009 kur janë mbledhur 67,58 milion denarë paraqet një rritje të vogël prej 1,9%.

Të ardhurat nga akcizat e duhanit dhe prodhimeve të duhanit në vitin 2010 arrin 4,454 milion denarë, ndërsa në vitin 2009 kanë qenë 4.622 milion denarë, që do të thotë se në vitin 2010 kemi ulje për 3,64%. Te duhani dhe prodhimet e duhanit për vitin 2010 është konstatuar ulje të sasisë së mallrave të duhanit nga prodhimi vendas në krahasim me vitin 2009. Në 2010 janë lëshuar dhe mbledhur akciza për gjithsejtë 178.950.000 marka kontrolluese, ndërsa për vitin 2009 186.200.000 marka kontrolluese, që paraqet ulje për 7.250.000 marka kontrolluese gjegjësisht ulje për 3,89%. Për dallim nga mallrat e duhanit nga prodhimi vendas, te mallrat e duhanit nga importi është konstatuar rritje të sasisë së mallrave të duhanit të importuar. Në vitin 2010 janë lëshuar gjithsejtë 41.000.000 marka kontrolli, ndërsa në vitin 2009 janë lëshuar 39.750.000 marka kontrolli, që paraqet rritje për 1.250.000 marka kontrolli gjegjësisht për 3.14%.

Të ardhurat e përgjithshme nga akcizat për vajrat minerale dhe prodhimeve akcize në vitin 2010 arrin 8.705 milion denarë, ndërsa në vitin 2009 kanë qenë 8.404 milion denarë, që do të thotë kemi rritje për 3,64%. Në pjesën e të ardhurave të akcizave të mbledhura nga importi në vitin 2010 është konstatuar rritje të të ardhurave prej 60% në krahasim me vitin 2009.

Të ardhurat nga akcizat e makinave të pasagjerëve në vitin 2010 arrin 419 milion denarë, në krahasim me vitin 2009 kur janë mbledhur 540 milion denarë, që do të thotë zvogëlim për 22,33%.





### II. KONTROLLI I ZBATIMIT TË LIGJEVE

Të ardhurat e llogaritura nga kompensimet në vitin 2010 arrin 761 milion denarë ku është 200% më shumë në krahasim me vitin 2009 kur janë llogaritur gjithsejtë 381 milion denarë. Rritje më të madhe ka te kompensimet të cilat paguhen për makinat e importuara të përdorura dhe kompensimet të cilat paguhen gjatë importit të derivateve të naftës. Kompensimet të cilat janë mbledhur gjatë importit të mallrave të duhanit në vitin 2010 arrin 370 milion denarë, ndërsa në vitin 2009 kanë qenë 325 milion denarë që paraqet rritje për 14%.

Në pjesën e mbledhjes së kompensimeve të cilat paguhen gjatë importit të vajrave minerale dhe derivateve të naftës, në vitin 2010 janë mbledhur 141 milion denarë, ku në krahasim me vitin 2009 paraqet rritje mbi 400%. Rritja ka të bëjë me sjelljen dispozitive ligjore për kompensime shtesë për rezervat e naftës së detyrueshme të cilat janë sjellë në fund të vitit 2009, për të cilat Drejtoria doganore është kompetente që të zbatoj gjegjësisht të mbledh gjatë procedurës doganore të importit.



### III. BURIMET NJERËZORE

#### 14. Përmirësimi i sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore

Në korrik 2010 është nënshkruar marrëveshje e re Kolektive të Drejtorisë doganore, tërësisht i harmonizuar me Ligjin për marrëdhënie pune dhe marrëveshjes së përgjithshme kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë. Si pjesë përbërëse të marrëveshjes kolektive, në gusht 2010 është miratuar Kod i ri i sjelljes të nëpunësve doganor me të cilin përcaktohet sjellja etike të nëpunësve doganor gjatë kohës së kryerjes të punëve, obligimet e tyre për respektimin e ligjeve, akteve nënligjore, marrëveshjet ndërkombëtare, dhe rregullohet mënyra e veprimit në situata të caktuara. Në gusht 2010 janë sjellë Rregulla të reja për rend dhe disiplinë në Drejtorinë doganore me të cilin rregullohet mënyra e sjelljes së të punësarave gjatë kohës së punës, obligimet e tyre ndaj punëdhënësit, obligimi për respektimin e rregullave dhe përgjegjësisë në rast të veprimit. .

Në nëntor 2010 është miratuar Rregullore për punë të kolegiumit të Drejtorisë doganore, me të cilin rregullohen të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të kolegiumit, fushëveprimi i punës, mënyra e thirrjes, mbajtjes dhe vendosjes së seancave të kolegiumit të Drejtorisë doganore me qëllim sigurimin ligjorë, efikas dhe kryerjen rationale të qëllimeve dhe kompetencat e Drejtorisë doganore.

**Në prill 2010 janë sjellë ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Drejtorinë doganore** („Gazeta zyrtare e RM” nr.48/10) që përcaktojnë kushtet për emërimin e drejtorit dhe zavendës drejtorin e Administratës doganore, dhe mënyra për ndërprerjen e mandatit të tyre, i cili ofron përzgjidhje të personave profesionist për kryerjen e këtyre funksioneve me përkushtim më të madh. Në dhjetor 2010 janë sjellë ndryshime dhe plotësime të reja të Ligjit për Administratën doganore (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 158/10) me të cilin më afër rregullohen kriteret e vendeve të punës në Administratën doganore, të cilat nuk status të nëpunësve doganor, por janë me status si nëpunës shtetëror. Me këto ndryshime dhe plotësime rregullohet edhe mbajtja e regjistrit të kundërvajtjeve, sanksioneve të shqiptuara dhe vendimeve të sjella në mënyrë të përcaktuar nga Ministri i Financave, në pajtueshmëri me Ministrin e Drejtësisë.

Drejtoria doganore ka vendosur mbulim të plotë informatik të evidentimeve dhe proceseve lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore, në kuadër të sistemit informatik të integruar- SII. Përveç akteve interne të miratuara më parë, në vitin 2010 janë sjellë aktet në vijim për rregullimin e punës të këtij sistemi:

- Në maj 2010 është sjellë Udhëzim për qasje në sistemin elektronik për evidentimin personal, me të cilin rregullohet përdorimi i evidentimit personal elektronik. Me këtë udhëzim vërtetohen të dhënat dhe evidentimet në sistemin elektronik të evidentimit personal të punonjësve, rregullohet mënyra e përditësimit të të dhënave, miratimi dhe autorizimi për qasje në evidentimin personal, si dhe përgatitjen e të dhënave dhe raporteve.
- Në prill 2010 është sjellë Doracak për punë me sistemin elektronik për evidentim personal, në kuadër të SII;
- Në gusht 2010 është sjellë Udhëzim për punë me softverin për regrutim dhe punësim. Me këtë softver sigurohet baza e vetme e të dhënave për kandidatët të



### III. BURIMET NJERËZORE

cilët paraqiten për punësim në shpalljet publike, si dhe transferimin automatik të kandidatëve të zgjedhur në bazën e të punësuarve.

#### 15. Trajnim dhe përmirësimi i aftësive profesionale

Në fund të vitit 2010 Drejtoria doganore ka përgatitur Strategji për trajnim dhe aftësim profesional të nëpunësve doganor 2011-2013. Strategjia ka për qëllim të krijoj një sistem të qëndrueshëm, stabil dhe gjithpërfshirës të trajnimeve dhe zhvillimit të nëpunësve doganor i cili do ti plotëson nevojat e ndryshme të administratës dhe të punonjësve doganor si individë dhe do të kontribuojë në realizimin e qëllimeve strategjike të Drejtorisë doganore.

#### Realizimi i programit për trajnim në Drejtorinë doganore për 2010

Sipas programit vjetor për trajnim, në vitin 2010 janë realizuar 174 ngjarje (253 në vitin 2009) – aktivitete në formë të trajnimeve, seminareve, punëtorive dhe prezantimeve. Në këto kanë marrë pjesë 1.865 nëpunës doganor (3.276 në vitin 2009) nga Drejtoria doganore. Në mesatare çdo pjesëmarrës në trajnim ka marrë 198 orë trajnim (90 orë në vitin 2009), ndërsa çdo i punësuar në Drejtorinë doganore në vitin 2010 ka marrë 28 orë trajnim (24 orë në vitin 2009) ose 4 ditë (3 ditë në 2009) trajnim dhe aftësim profesional. Trajnuesit e trajnuar dhe ekspertët nga projekti kanë mbajtur gjithsejtë 12 trajnime në të cilën kanë marrë pjesë 194 nëpunës doganor. Në vitin 2010 janë mbajtur edhe trajnimet themelore programuese të planifikuara për nëpunësit doganor të sapo punësuar edhe atë: për 31 nëpunës doganor me kohëzgjatje prej 160 orë, për 30 nëpunës doganor me kohëzgjatje prej 144 orë dhe për 49 nëpunës doganor me kohëzgjatje prej 40 orë.

Përveç trajnimeve të realizuara nga ana e trajnuesve të Drejtorisë doganore, pjesë e trajnimeve janë realizuar në organizim të shërbimeve doganore të huaj dhe organizatave ndër të cilat:

- Punëtori, seminare dhe vizita studiuuese përmes instrumentit për ndihmë teknike dhe shkëmbimit të informatave – TAIEX të BE,
- Programi për ndihmë teknike nga Drejtoria Doganore dhe Tatimore të Holandës, me temë të lidhur me menaxhimin me burimet njerëzore dhe udhëheqjen të dedikuar për udhëheqësinë e lartë.
- Qeveria e SHBA, në fushën e kontrolleve dhe hetimeve,
- Programi për bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Sllovenisë në fushën e laboratorisë doganore, futjen e informacionit para arritjes dhe para nisjes dhe trajnim për negociata me BE,
- Përmes projekteve IPA-komponenta për përforsimin e kontrolleve kufitar, është mbajtur trajnim për trajnues për menaxhimin e integruar të kufinjve dhe etikës.

Me qëllim përmirësimin e kapacitetit të saj për sigurimin e trajnimit dhe trajnimit të punonjësve, në kuadër të IPA 2007 nënprojekti “Ndihmë teknike për përforsimin e kontrollit kufitar”, Drejtoria doganore ka organizuar trajnim për trajnuesit i cili ka përfshi më shumë tema: roli dhe përgjegjësit e trajnuesit, stilet e të mësuarit, qëllimet e të mësuarit, zhvillimi i modulit për menaxhimin e koordinuar kufitar dhe etika dhe

### III. BURIMET NJERËZORE

dërgesa e moduleve. Gjithashtu, në vitin 2010 është realizuar trajnim për trajnuesit për zbatimin e Ligjit të ri për procedurë penale dhe Ligjit Penal me temë shqyrtim direkt të organizuar nag Ambasada e SHBA.

Gjatë vitit 2010 sistemi ekzistues për video konferencë është modernizuar me pajisje të reja që krijojnë mundësi për përfshirjen e përdoruesve të kompjuterëve personal pa nevojën e përdorimit e pajisjeve të specializuara. Përreth video lidhjeve aktuale të përhershme të Doganave me Drejtorinë, është krijuar mundësi për përfshirjen e njësive doganore në sistemin, ndërsa me këtë mundësohet edhe mbajtjen e trajnimeve përmes sistemit, pa nevojën e udhëtimit të punonjësve dhe mundëson efikasitet të mëtutjeshëm në punë.

#### Futen modulet e Komisionit Evropian për doganat dhe e-learning

Përmes programit të Komisionit Evropian “Dogana 2013”, janë përgatitur kurse për mësim elektronik të temave aktuale nga puna doganore, të vërtetuara nga ana e Komisionit Evropian. Deri tani janë përgatitur kurse për mësim elektronik me temë:

- Regjistrimi dhe identifikimi i operatorëve ekonomik (EORI),
- Miratimi i vetëm për procedura të thjeshtuara (SASP),
- Operator ekonomik të autorizuar (AEO),
- Kontrolli i kontejnerëve,
- Kontrolli i prekursorëve të drogës për operator ekonomik,
- Kontrolli i prekursorëve të drogës për nëpunës doganor dhe
- Direktiva e TVSH

Të gjitha kurset e lartpërmendura për mësim elektronik, Drejtoria doganore gjatë vitit 2010 i ka përkthyer dhe i ka vendosur në faqen e internetit gjegjësisht intranetit me qëllim që të njëjtat të jenë lehtë të kapshme edhe për bashkëpunëtorët e biznesit edhe për doganierët. Kurset për mësim elektronik duhet të kontribuojnë drejt zbatimit më të mirë dhe më efikas të legjislacionit doganor, si dhe drejt harmonizimit dhe thjeshtëzimit të procedurave doganore. Ato mundësojnë edhe zbatimin uniform të ligjeve dhe dispozitave të territorit doganor të Republikës së Maqedonisë. Kurset për mësim elektronik nuk janë dedikuar për nëpunësit doganor, por për bashkësinë e biznesit dhe për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën doganore – shpediter, importues dhe eksportues. Kjo qasje e re në trajnim dhe aftësimi profesional mundëson mbulimin e vazhdueshëm në shumë fusha nga interesi i përbashkët për pjesëmarrësit në procedurat doganore. Meqenëse përdorimi i tyre është pa pagesë nuk krijohet asnjë kosto shtesë. Ndër tjera, sigurohen shembuj praktik për lehtësimin e tregtisë. Të gjitha kurset për mësim elektronik janë dispozicion në faqen e internetit dhe të intranetit të Drejtorisë doganore.





### III. BURIMET NJERËZORE

#### Trajnim përmes programit TAIEX të Komisionit Evropian

Në vitin 2010 janë realizuar shumë misione të ekspertëve përmes instrumentit TAIEX të Komisionit Evropian. Është punuar për temët në vijim: tarifa doganore, vlera doganore (Gjermania), EORI- koncepti për regjistrim dhe identifikim të operatorëve ekonomik (Çeki), aplikacioni i metodëve në laboratorinë doganore (Finlandë), sistem për kodimin e masave në TARIK (Belgjikë), mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale, informacion para nisjes dhe para arritjes së dërgesave (Shkup), konventa për procedurë të përbashkët tranziti, kërkimi i të dhënave doganore, tatimore dhe akcize, njohja me ligjin doganor të modernizuar të BE, kontrolli i mallrave akcize (Angli), rregullat për prejardhje dhe mbikëqyrja e tragut.

Në vitin 2010 Drejtorisë doganore i është lejuar 15 misione TAIEX nga ana e Komisionit Evropian.

#### 16. Integriteti dhe lufta kundër korrupsionit

Në vitin 2010 Drejtoria doganore ka vazhduar me aktivitetet për përmirësimin e sistemeve për identifikimin e pikave të rrezikshme që i nënshtrohen korrupsionit, zbulimit dhe sanksionimit të shkeljeve disiplinore dhe keqpërdorimi i detyrës zyrtare.

##### Mbështetja sistematike

Në fund të vitit 2010 Drejtoria doganore ka përgatitur **Strategji të reviduar për integritet dhe luftë kundër korrupsionit në Drejtorinë doganore për vitin 2011-2014**. Strategjia ka për qëllim të vendos qasje proaktive në luftën kundër korrupsionit, ku theksi do të vendoset në prevencionin para represionit.

Për zbatim të plotë të detyrimeve për shkatërimin e keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe konfliktit të interesave, në maj 2010 është miratuar Udhëzim për punë me softverin për evidentim të listave anketuese, me të cilën rregullohet mënyra, procedura, kompetencat dhe autorizimet për administrimin dhe përdorimin të evidentimit elektronik të listave anketuese për gjendjen pronësore të të punësuarve në Drejtorinë doganore, në kuadër të sistemit të Integruar Informatik.

Në shkurt 2010 Drejtoria doganore ka miratuar Udhëzim të ri për sistemin e kontrollit të brendshëm të Drejtorisë doganore, me të cilin rregullohet sistemi kontrollues i brendshëm si një proces i vazhdueshëm i cili përfshin të gjitha llojet e kontrolleve financiare dhe llojet tjera. Në Drejtorinë doganore punohet me aktivitete të madh në mirëkuptimin dhe pranimin e sistemit kontrollues të brendshëm nga ana e udhëheqësve të njësive organizative, definimi formal i proceseve, reziqeve dhe kontrolleve, përmirësimi i menaxhimit me rreziqet, përmirësimi i kontrolleve, që në fund të arrihet dhe të mbahet qëllimi përfundimtar të sistemit kontrollues të brendshëm- duke minimizuar rreziqet në punën me kontrollet përkatëse dhe përmbushjen e saktë, të plotë dhe me kohë e qëllimeve dhe objektivave të vendosura. Në vitin 2010 është



### III. BURIMET NJERËZORE

vendosur sistem i kontrollit të brendshëm në 70 njësi organizative të Drejtorisë doganore, ku janë përgatitur 552 procedura pune të shkruara..

#### Dega doganore më e mirë

Në tremujorin e parë të vitit 2010, për njësi më të mirë kufitare doganore është zgjedhur njësia doganore Tabanovc-Autostradë, Dogana e Komunovës, ndërsa për njësi më e mirë e mbrendshme është zgjedhur njësia doganore Shkup 3, Dogana e Shkupit. Për tremujorin e dytë, për njësi më të mirë kufitare doganore është zgjedhur njësia doganore Tabanovc-Autostradë dhe Stacioni Hekurudhor Tabanovc, Dogana e Komunovës, ndërsa për njësi më të mirë të brendshme është zgjedhur njësia doganore Kumanovë, Dogana e Kumanovës.

Në tremujorin e tretë për njësi më të mirë kufitare janë zgjedhur njësia doganore Tabanovc-Autostradë dhe Bogorodica, Dogana e Kumanovës dhe Gjevgjeliçë, ndërsa për njësi më të mirë të brendshme është zgjedhur njësia doganore Shkup 3, Dogana e Shkupit. Në tremujorin e fundit të vitit 2010 për njësi më të mirë kufitare është zgjedhur njësia doganore Bogorodice, Dogana e Gjevgjeliçë, ndërsa për njësi të brendshme më të mirë është zgjedhur njësia doganore Shkup 1, Dogana e Shkupit.

#### Aktivitetet sindikale

Sindikata e pavarur e Drejtorisë doganore ka vazhduar me traditën në organizimin e lojrave sindikale sportive. Në vitin 2010 në Ohër u mbajtën lojrat sportive në shtatë disiplina: futboll të vogël, basketboll, volejball, gjuajtje, shah, ping-pong dhe tërheqje litar. Në lojrat kanë marrë pjesë 150 pjesëmarrës. Mëyra e këtillë e shoqërimit dhe bashkëpunimi i punonjësve në Drejtorinë doganore, kanë kontribuar nëpërmirësimin e komunikimit, përforcimin e mëtejme të bashkëpunimit dhe punës ekipore.



#### Shënimi i 18 vjetorit të ekzistimit, suverenitetit dhe kontrollit ndaj territorit doganor të Drejtorisë doganore të Republikës së Maqedonisë

Me 14.04.2010 Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë solemnisht shënoi 18 vjetorin e ekzistimit, suverenitetit dhe kontrollit ndaj teitorrit doganor të Republikës së Maqedonisë, në praninë e përfaqësuesve të lartë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor në Republikën e Maqedonisë, institucioneve shtetërore, Bashkësisë së biznesit, shoqeatat e tyre dhe bashkëpunëtor tjerë të Drejtorisë doganore. U prezentuan rezultatet nga puna e Drejtorisë





### III. BURIMET NJERËZORE

doganore të realizuara në vitin e kaluar, shprehi falemenderim te bashkëpunëtorët e përhershëm dhe partnerët e Drejtorisë doganore dhe u shpërblyen nëpunësit doganor dhe njësitë doganore të cilët u dalluan në kryerjen e detyrave të tyre punuese. Nëpunësit doganor të ri para drejtorit të Drejtorisë doganore bënë betimin se do ti respektojnë Kushtetutën dhe Ligjet e Republikës së Maqedonisë dhe se profesionalisht, dhe me nder do ti kryejnë obligimet e tyre punuese. Doganierë të cilët kanë mbushur 30, 20 dhe 10 vjet përvoje pune në shërbimet doganore ju është dhënë arri dhe argjend. Në shënimin solemn i parapriu edhe aksioni për dhurimin e gjakut ku më shumë se 100 punonjës doganor, në 3 pikë në të gjithë vendin dhuruan mbi 100 njësi gjak.

Në kuadër të aktiviteteve me rastin e Ditës të Drejtorisë doganore, me 15 prill 2010 në Fakultetin Ekonomik në Shkup përfaqësues të Drejtorisë doganore kanë mbajtur një prezentim me temë “Sfidat dhe përgjegjësitë e shërbimit doganor për plotësimin e standardeve për anëtarësimin në BE para dhe pas aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkësinë Evropiane” para studentëve dhe profesorëve nga fakulteti ekonomik dhe juridik në Maqedoni dhe përfaqësuesve të Trupit këshidhënës.

#### 17. Ndalimi i shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe konfliktit të interesave

##### Kontrolle të brendshme

Në vitin 2010 janë kryer 86 kontrolle në të gjitha njësitë organizative të Drejtorisë doganore (krahasuar me 58 në vitin 2009, 46 në vitin 2008, 33 në 2007 dhe 22 në vitin 2006). Nga tabela e paraqitur mund të vërehet se me 53 kontrolle kryera, në vitin 2010 i është dhënë vëmendje të veçantë rregullsisë në punë në Drejtorinë qendrore, krahasuar me vitin 2009 kur janë kryer 35 kontrolle, në vitin 2008 17 kontrolle dhe veçanarisht në vitin 2007 kur në Drejtorinë qendrore janë kryer vetëm 2 kontrolle. Bazuar në kontrollet e kryera, vazhdohet me hetimet e brendshme për hetimin e ekzistimit të përgjegjësisë disiplinore, si dhe me marrjen e masave hetuese dhe hetimit kundër kryerësve të kundërvajtjes doganore dhe veprave penale

Organizimi	Numri i kontrolleve				
	2010	2009	2008	2007	2006
Drejtoria qendrore	53	35	17	2	
Dogana e Shkupit	14	8	9	10	16
Dogana e Kumanovës	5	4	2	1	1
Dogana e Shtipit	3	4	8	9	2
Dogana e Manastirit	10	2	5	6	2
Dogana e Gjevgjeliës	1	5	5	5	1
<b>Gjithsejtë</b>	<b>86</b>	<b>58</b>	<b>46</b>	<b>33</b>	<b>22</b>

##### Hetime të brendshme

Gjatë vitit 2010 deri te Sektori për përgjegjësi profesionale, nga ana e Departamentit për koordinim dhe komunikim janë dorëzuar 142 ankesa të pranuar përmes linjës së hapur telefonike doganore (197). Nga gjithsejtë ankesat e dorëzuara, në 16 raste janë kryer hetime të brendshme dhe janë përgatitur raporte përfundimtare në lidhje me të njëjtat, ndërsa në 66 raste, kur janë marrë aktivitetet për konstatimin e thënjeve të nxjerra nga pariqitja, është konstatuar se janë të pabaza. 60 ankesa të mbetura janë shqyrtuar, por në lidhje me të njëjtat nuk mund të veprohet nga arsyeja se të njëjtat



## RAPORT PËR PUNËN E DREJTORISË DOGANORE NË VITIN 2010

### III. BURIMET NJERËZORE

nuk përmbajshin të dhëna të verifikueshme për bërjen e veprës penale nga të punësuar ose shkelja serioze e rregullave për rend dhe disiplinë.

Në vitin 2010 janë kryer 112 hetime të brendshme (krahasuar me 127 në 2009, 140 në 2008, 240 në 2007 dhe 71 në 2006), ku në 27 raste janë konstatuar shkelje disiplinore dhe parregullsi (krahasuar me 52 në 2009, 70 në 2008, 87 në 2007). Për dallim nga viti 2007 dhe 2006 kur në

Drejtorinë qendrore nuk është kryer asnjë hetim i brendshëm, në vitin 2009 janë kryer 44, ndërsa në vitin 2008 janë kryer 20 hetime, ndërsa në vitin 2010 në Drejtorinë qendrore janë kryer 65 hetime të brendshme. .

Organizimi	Numri i hetimeve				
	2010	2009	2008	2007	2006
Drejtoria doganore	65	44	20		
Dogana e Shkupit	18	24	33	65	23
Dogana e Kumanovës	15	24	22	29	17
Dogana e Shtipit	3	11	18	57	7
Dogana e Gjevgjelisë	6	12	22	62	10
Dogana e Manastirit	5	12	25	27	14
<b>Gjithsejtë</b>	<b>112</b>	<b>127</b>	<b>140</b>	<b>240</b>	<b>71</b>

#### Procedura disiplinore

Në vitin 2010 pas marrjes së propozimeve për fillimin e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë për shkeljen e rendit dhe disiplinës janë ngritur 21 procedura disiplinore (99 në vitin 2009). Në vitin e njëjtë janë shqiptuar 10 vendime për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me pushim nga puna, 16 vendime për ndërprerjen e procedurës për shkak mos konstatimit të përgjegjësisë ose kufizimit, 13 vendime për gjobë prej 15% të pagës mujore të fundit për një periudhë prej një deri në gjashtë muaj dhe një paralajmërim me shkrim. Për shkak rezultateve të pakënaqshme të treguara në punë nga ana e punonjësve doganor janë miratuar 85 vendime për uljen e pagës prej 15% për muajin aktual.

Në vitin 2010 është shqiptuar një suspendim të një nëpunësi doganor për shkak bërjes së veprave penale lidhur me kryerjen e detyrave zyrtare (16 në 2009).

#### Kallëzime penale

Në vitin 2010 nga ana e Drejtorisë doganore janë ngritur 5 kallëzime penale kundër 4 nëpunësve doganor edhe atë; një kallëzim penal kundër një ish punonjës në Drejtorinë doganore për dhënien e deklaratës së rrejshme, një kallëzim penal kundër një nëpunësi doganor për punë të pakujdesshme në shërbim, 3 kallëzime penale kundër një punonjës dhe një ish-punonjës në Drejtorinë doganore për ndihmë në kryerjen e kontrabandës..

Në periudhën e njëjtë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme është ngritur 1 kallëzim penal për bërjen e veprës penale keqpërdorim të detyrës zyrtare me mashtrim kompjuterik dhe një kallëzim penal kundër një nëpunësi doganor për përvetësim. Në muajin gusht me zbatimin e masave të posaçme hetimore është ngritur kallëzim penal për bërjen e veprës penale marrjes së rryshfetit kundër punonjëse doganore. Në bashkëpunim me Policinë Financiare është ngritur 1 kallëzim penal





### III. BURIMET NJERËZORE

kundër 3 nëpunësve doganor për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Me marrjen e aktiviteteve parahetuese në bashkëpunim Departamenti për krim të organizuar pranë MPB dhe Drejtoria për polici financiare është përgatitur 1 kallëzim penal kundër 4 personave nga të cilët 1 punonjës doganor për ndihmë në kontrabandë dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Nga gjithsejtë 216 lëndë penale të evidentuara kundër 182 nëpunësve doganor (të mëparshëm dhe të tanishëm), në majin dhjetor 2010 janë sjellë 81 aktgjykime të shkallës së parë nga të cilat 57 të plotëfuqishme, 24 gjenden në procedurë në gjykatat e apelit. Gjykata Supreme 24 raste i ka kthyer lëndët përsëri në procedurë të cilat janë me afat prej 3 deri 7 vjet. Te gjykatat themelore në procedurë diskutimi gjenden 20 lëndë. Kallëzime penale kundër 27 personave akoma janë në fazën e hetimit gjyqësor, ndërsa kundër 17 personave lëndet janë në fazë të sjelljes së një aktakuze. Për ngritjen e kallëzimeve penale kundër punonjës doganor të mëparshëm dhe të tanishëm në 47 raste Drejtoria doganore nuk ka informacion në cilën fazë nga procedura penale gjenden.



### IV. PROCEDURA ADMINISTRATIVE DHE PËRKRAHJA LOGJISTIKE

Në vitin 2010 Drejtoria doganore ka vazhduar të punoj në përmirësimin e mëtejshëm të sistemeve administrative dhe logjistike, veçanarisht në fushën e rritjes së efikasitetit në zbatimin e procedurave dhe punës administrative, rritjen e efikasitetit dhe mbikëqyrjes në menaxhimin me burimet financiare, si dhe përmirësimin e manxhimit me burimet jo-financiare dhe të tjera të Drejtorisë doganore.

#### 18. Proceset administrative dhe procedurat

Organizimi i mirë i punës administrative siguron dhënien e shërbimeve me kohë dhe kualitative ndaj qytetarëve, kompanive dhe përdoruesve tjerë, si dhe kryerjen më efikase të detyrimeve dhe obligimeve të Drejtorisë doganore me të gjitha fushat.

##### **Futja e sistemit elektronik për menaxhimin me dokumentet-EDMS<sup>1</sup>**

Pas përfundimit të testimit dhe punës paralele në letër dhe ambient elektronik, nga 01.01.2010 në Drejtorinë doganore është bërë i detyrueshëm përdorimi i sistemit elektronik për menaxhimin me dokumente- EDMS. EDMS përfshin arkivimin dhe përpunimin e dokumenteve elektronike dhe kopje elektronike të dokumenteve në letër, qarkullimi i dokumenteve elektronike dhe nënshkrimi elektronik, ndjekja elektronike e statusit të dokumenteve nga aspekti i përgatitjes, distribuimi, qarkullimi, arkivimi, lokacioni, autenticiteti, siguria dhe historia. EDMS përfshin mbi 170 procese punuese të identifikuara dhe të përshkruara, përcakton afate maksimale për përfundimin e proceseve punuese, llojet standarde të dokumenteve dhe nënshkrimin elektronik të dokumenteve. EDMS mundëson pranimin e dokumenteve elektronike të centralizuara dhe në letër, kopje autentike të autorizuara të dokumenteve në letër, arkiva të centralizuara fizike dhe logjike, autorizimi dhe siguria e dokumenteve në nivel të dokumenteve individuale, njësia organizative, grupa e përdoruesve/funksionaliteteve/privilegjeve dhe proceseve punuese, kërkimi elektronik dhe ndjekja e dokumenteve, skanimi, klasifikimi, shënimi, inçizimi, pranimi dhe dërgimi i postave hyrëse, dalëse dhe interne, emërimi i kompetencave për dokumentet, faza e proceseve punuese, si dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve me bashkëpunëtor të jashtëm. Funksionimi i EDMS është rregulluar me aktet në vijim të miratuara nga ana e Drejtorisë doganore:

- Në janar 2010 është miratuar Udhëzim për punë me sistemin elektronik për menaxhimin me dokumente, me të cilin rregullohet mënyra e punës dhe qarkullimi i dokumenteve në njësitë organizative të Drejtorisë doganore përmes EDMS, dorëzimi i dokumenteve origjinale deri te njësitë organizative, si dhe obligimet dhe kompetencat e punonjësve në Drejtorinë doganore,
- Në janar 2010 është sjell Doracak për komunikim intern në mes njësive organizative në EDMS, me të cilin rregullohet komunikimi horizontal dhe vertikal të dokumenteve elektronike në mes njësive organizative të Drejtorisë doganore;
- Në janar 2010 është sjellë Udhëzim për nënshkrimin elektronik të dokumenteve në EDMS;
- Në janar 2010 janë sjellë Rregulla për punë në EDMS helpdesk i cili ka për qëllim dhënien e ndihmës teknike dhe këshilla për përdoruesit për shmangien e

<sup>1</sup> Electronic Document Management System



### IV. PROCEDURA ADMINISTRATIVE DHE PËRKRAHJA LOGJISTIKE

- problemeve në funksionimin e EDMS, si dhe dhënien e kahjeve dhe marrjen e masave për përmirësimin e EDMS;
- Në janar 2010 është sjellë udhëzim administrativ për dorëzimin e mundësive për notifikimet e autorizuara në EDMS edhe atë: e\_mail njoftim e punonjësve gjatë ndryshimit të fazës së lëndës dhe SMS njoftimet për palët;
  - Në janar 2010 është miratuar Udhëzim për punë me EDMS për përdorues të Web klient (EDMS është Web aplikacion);
  - Në janar 2010 është miratuar Udhëzim për ndryshimin e fjalëkalimit të Web faqes të Drejtorisë doganore për përdorimin e EDMS;
  - Në janar 2010 është miratuar Udhëzim për Web skenimin e dokumenteve, pajisje për web skanimin të dedikuar për skanimin e verzioneve në letër nga dokumentacioni përmes përdorimit të web verzionit të EDMS, në dispozicion për të gjithë përdoruesit e EDMS;
  - Në janar 2010 është miratuar Udhëzim për përpunimin e dokumenteve nga lloji i faturave në EDMS;
  - Në gusht 2010 është miratuar Udhëzim për evidentimin e lëndve administrative në EDMS, me të cilën rregullohet evidentimi në regjistrin për lëndë nga shkalla e parë administrative (formulari UP1);
  - Në gusht 2010 është sjellë Udhëzim për kërkimin e akteve interne, termet dhe përkufizimet ndërkombëtare doganore në EDMS, me të cilin përshkruhet mënyra e kërkimit të akteve interne të sjlla nga ana e Drejtorisë doganore, si dhe termet dhe përkufizimet ndërkombëtare doganore;
  - Në nëtor 2010 është sjellë Udhëzim për punë me bazën e të dhënave aktive, pasive dhe të përhershme në EDMS, i cili mundëson punë të lehtë dhe të shpejtë të funksionaliteteve dhe procedurave gjatë punës me të tre bazat në sistemin.

#### **Rregullimi i punës me vulat dhe pullave**

Në tetor 2010 Drejtoria doganore ka miratuar Udhëzim për vulat dhe pullat e Drejtorisë doganore, me të cilën rregullohet forma, madhësia, përmbajtja, furnizimi, evidentimi, mënyra e ruajtjes, përdorimit dhe shkatërimit të vulave dhe pullave të cilat përdoren në kryerjen e punëve nga kompetencat e tyre të caktuara me ligj.

#### **Rregullimi i mënyrës së përgatitjes të akteve të mbrendshme**

Në qershor 2010 Drejtoria doganore ka miratuar Udhëzim për përgatitjen e akteve interne në Drejtorinë doganore, me të cilën janë përcaktuar llojet e akteve të cilat përgatiten në Drejtorinë doganore, kompetencat për përgatitjen e tyre, mënyra e përgatitjes së akteve, forma dhe teknika e përgatitjes, kontrolla e akteve interne, përshtatja, ndryshimi, plotësimi, revidimi ose shfuqizimi i tyre.

#### **Rregullim i mënyrës të mbledhjes së taksave administrative**

Në gusht 2010 Drejtoria doganore ka miratuar udhëzim për mënyrën e mbledhjes së taksave administrative në Drejtorinë doganore, me të cilin rregullohet trajtimi i aplikimeve në të cilat paguhet taksë administrative, llojet e taksve administrative të



### IV. PROCEDURA ADMINISTRATIVE DHE PËRKRAHJA LOGJISTIKE

cilat mbledhen në Drejtorinë doganore, kontrolli, vërtetimi i pagesës, kthimi i pagesës së tepërt të taksave administrative, kompetencat dhe afatet për veprim.

#### 19. Sigurimi dhe mbrojtja

- Në shtator 2010 është miratuar Udhëzim për pranimin e palëve në Drejtorinë doganore, me të cilën rregullohet mënyra e pranimin dhe identifikimin i personave të cilët nuk janë punonjës ose nuk kanë të rregulluar qëndrim në objektet e Drejtorisë doganore;
- Në nëntor 2010 është miratuar Udhëzim për sigurimin e pronave dhe personave në Drejtorinë doganore, me të cilën rregullohet mënyra e sigurimit të pronave dhe personave në hapësirat e Drejtorisë doganore;
- Në dhjetor 2010 është miratuar Udhëzim për mbrojtjen dhe veprimin në rast zjarri, me të cilën rregullohen masat parandaluese për mbrojtjen nga shpërthimi i zjarrit dhe mënyra e veprimin në rast zjarri në ndërtesat, pikat kufitare, терминаlet doganore, depot dhe hapësirat tjera punuese me të cilat udhëheq Drejtoria doganore;
- Në nëntor 2010 është miratuar Udhëzim për veprim sipas dëmit të bërë nga automjetet në pikat kufitare ose терминаlet doganore, me të cilin rregullohet procedura për paraqitjen e dëmëve, të bëra nga automjetet, ndaj ndërtesave dhe pajisjeve në pikat kufitare ose терминаle doganore ku janë në pronësi ose në përdorim të Drejtorisë doganore;
- Në shkurt 2010 është miratuar udhëzim të ri për kohën punuese në Drejtorinë doganore, me të cilin rregullohet koha punuese në Drejtorinë doganore, puna jashtë orarit të punës, pauza gjatë ditës, mungesa gjatë orarit të punës, mënyra dhe procedura për evidentimin e kohës të kaluar në punë, shmangie nga koha punuese e plotë, mënyra e regjistrimit të kohës së kaluar në punë, si dhe qasja deri dhe në hapësirat e Drejtorisë doganore nga punonjësit dhe personat e jashtëm.

#### 20. Kritja e efikasitetit në menaxhimin me burimet njerëzore

Organizimi i mirë i menaxhimit me burimet njerëzore mundëson përdorim të plotë të financave për nevojat prioritare për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të Drejtorisë doganore. Në vitin 2010 Drejtoria doganore ka zbatuar përparimet në vijim në këtë fushë.

#### **Rregullimii punës financiare dhe materiale me plotësimin e mbështetjes informatike**

Gjatë vitit 2010 është rregulluar përdorimi i sistemit informatik për punën materiale dhe financiare në të gjitha fushat:

- Në prill 2010 Drejtoria doganore ka miratuar Udhëzim për punë me softverin për punë materiale dhe financiare - ERP<sup>2</sup>, të futur në kuadër të sistemit të integruar informativ – SII. Me këtë udhëzim rregullohen punët, kompetencat dhe detyrimet e njësive organizative dhe të punësuarve në Drejtorinë doganore gjatë përdorimit të ERP. Sektori për kontabilitet dhe financa e përdor ERP në fushën e punës

<sup>2</sup> ERP – Enterprise Resource Planning



### IV. PROCEDURA ADMINISTRATIVE DHE PËRKRAHJA LOGJISTIKE

- financiare, ndërsa Sektori për punë administrative dhe teknike e përdor në fushën e punës materiale, përveç në modulën e evidentimit të materialeve laboratorike të cilat i përdor Sektori për sistem doganor;
- Sistemi për përgatitjen dhe realizimin e buxhetit është rregulluar me Udhëzim për punë me softverin për buxhet, i cili është miratuar në prill 2010 i cili softver siguron përkrahje elektronike të përgatitjes dhe miratimin e buxhetit të Drejtorisë doganore;
  - Të njëjtin muj është sjellë Udhëzim për punë me softverin për llogaritjen e pagave, i cili shërben për përpunimin automatik të pagave;
  - Regjestrin kontabël të kërkesave, detyrimeve, të ardhurave dhe të dalat është përkrahur dhe rregulluar me Udhëzim për softver për planifikim të burimeve në institucion – Modul për operative financiare të sjellë në qershor 2010;
  - Menaxhimi me furnizimet publike është rregulluar më tej me Udhëzim për softver për planifikimin e burimeve në institucion – Modul për plan të furnizimeve publike të sjellë në qershor 2010, me të cilin rregullohet regjistrimi i planit të sjellë për furnizime publike, ndryshimet, plotësimet dhe realizimin e tij;
  - Evidentimi, llogaritja dhe pagesa e shpenzimeve për udhëtimet zyrtare të të punësuarve, në vend dhe jashtë vendit, është përkrahur në mënyrë informatike dhe rregulluar me Udhëzim për punë me softverin për urdhëresë pagese, të sjellë në maj 2010;
  - Me qëllim harmonizimit me EDMS, Drejtoria doganore në mars 2010 ka miratuar ndryshime të Udhëzimit për likuidimin e dokumenteve kontabël.

#### **Përmirësimi i mëtëjshëm i sistemit për kontroll të shpenzimeve**

Në prill 2010 Drejtoria doganore ka sjellë Udhëzim për përdorimin e mjeteve buxhetore për reprezentim, me të cilin rregullohen të drejtat dhe detyrimet gjatë përdorimit të mjeteve buxhetore për këtë dedikim. Në maj 2010 është sjellë Udhëzim për mënyrën dhe procedurën për mbajtjen e mjeteve nga paga e të punësuarve, i cili rregullon mënyrën e llogaritjes dhe mbajtjes nga paga e punonjësve në bazë akteve ekzekutive të plotfuqishme. Miratuar udhëzim për përdorimin e sistemit për kontroll dhe kufizimin e telefonave fikse, me të cilin përmirësohet kontrolli dhe zvogëlohen shpenzimet për shërbimet e telefonave fikse. Sistemi për kontroll dhe kufizim të telefonave në Drejtorinë Qendrore është përbërë nga servisi për marrjen e të dhënave nga qendra telefonike, servis për distribuimin e të dhënave nga qendra telefonike deri te baza e të dhënave dhe aplikimi për zbatim dhe kontroll të të dhënave të marra nga qendra telefonike..

#### **Përmirësimi i mëtëjshëm të sistemit për kontroll të t ardhurave**

Drejtorija doganore vazhdimisht punon në forcimin dhe përmirësimin e sistemit për kontroll të mbledhjes së të ardhurave, ku në vitin 2010 zbatoi masat në vijim:

- Në maj 2010 është sjellë Udhëzim për veprim me pagesën në llogarinë evidnetuese të Drejtorisë doganore, me të cilin rregullohet administrimi i qarkullimit dhe gjendja e pagesës në emër të të dhënave importuese;
- Në shkurt 2010 është sjellë Udhëzim për punë me softverin për fakturimin e qirave në kuadër të EDMS, me të cilin rregullohet fakturimi i qirave për objektin e dhënë në pikat kufitare për qarkullimin rrugor.



#### IV. PROCEDURA ADMINISTRATIVE DHE PÛRKRAHJA LOGJISTIKE

##### Evidentimi kontabël

Me qëllim sigurimin e plotë dhe uniform e evidentimit të mjeteve dhe obligimeve, në maj 2010 janë sjellë rregulla kontabël për regjistrimin e stoqeve në Drejtorinë doganore, me të cilin rregullohet mënyra e regjistrimit të stoqeve në Drejtorinë doganore, gjegjësisht operacionet dhe veprimet të cilat kryhen në sistemin elektronik për materialet dhe regjistrimin e financave. Njëkohësisht, janë sjellë edhe rregulla kontabël për regjistrimin e tatimeve, me të cilat rregullohet mënyra e regjistrimit kontabël të tatimeve në formë materiale dhe financiare, me të cilin rregullohet mënyra dhe procedura e relaizimit dhe pranimit të tatimeve dhe regjistrimin e tyre kontabël, si dhe mënyrën e kryerjes së kontrollit të përdorimit të tyre.

##### 21. Rritja e efikasitetit në menaxhimin me burimet jo-financiare

Në drejtim të përparimit të mëtejshëm të përdorimit dhe mbikëqyrjes të burimeve jo-financiare, në vitin 2010 janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Në maj 2010 është miratuar Udhëzim për punë me softverin për regjistrimin e aseteve themelore, me të cilin rregullohet administrimi dhe përdorimi i këtij softveri. Të njëjtin muaj është miratuar Udhëzim për softver për regjistrimin e sendeve themelore, me të cilin përshkruhet regjistrimi i sendeve themelore dhe obligimi i të njëjteve në punënjës dhe lokacion.
- Në shkurt 2010 është miratuar Udhëzim për punë me softverin për regjistrimin e materialeve laboratorike në kuadër të softverit ERP;
- Në shkurt 2010 është miratuar Udhëzim për punë me softverin për regjistrimin e mallrave të konfiskuar, në kuadër të ERP, me të cilin rregullohet veprimi me mallrat e konfiskuar përkohësisht, të lënë në dobi të shtetit dhe mallit të marrë definitivisht. Në qershor 2010 është miratuar Udhëzim i ri për mënyrën e veprimit me mallrat e konfiskuar dhe të lëna në dobi të shtetit, me të cilin vërtetohet mënyra e veprimit me mallrat e konfiskuara përkohësisht dhe të definitivisht të mara dhe mallrat të lënë në dobi të shtetit në procedurë administrative sipas dispozitave të Ligjit doganor, regjistrimin e tyre, vendosjen dhe rrugës, shitjen dhe shpërndarjen e parave të fituar nga shitja, kompetencat dhe përgjegjësitë në Drejtorinë doganore, si dhe për mënyrën e veprimit me mallrat të cilat përkohësisht konfiskohen në procedurë kundërvajtës ose penale ose për shkak shkeljes të së drejtës nga pronësia intelektuale;
- Për përdorim optimal dhe menaxhimin me teknologjinë informatike, mbrojtjen e të dhënave, punë efektive, efikase dhe të sigurtë të sistemeve TIK dhe infrastrukturën teknike të cilat i përkrahin në qershor 2010 është miratuar Udhëzim për veprim me sistemet TIK nga aspekti i sigurisë TIK.

##### Ndërtimi i vendkalimit kufitar Bllacë (kufiri Maqedoni-Kosovë)

Në qershor 2010 ka filluar ndërtimi i vendkalimit kufitar Bllacë – pjesa e udhëtarëve në kufirin Maqedoni-Kosovë. Projekti është financuar me kredit nga Banka Botërore në kuadër të projektit të dytë për përsheptimin e transportit dhe tregtisë. Vendkalimi i ri i cili do të mundëson rrjedhje më të shpejtë të makinave do të jenë në funksion për 14 muaj.



**IV. PROCEDURA ADMINISTRATIVE DHE PËRKRAHJA LOGJISTIKE**

**Marrëveshja e lidhur për bashkëpunim mes Drejtorisë doganore dhe operatorin e aeroportit TAV Maqedoni**

Drejtoria doganore dhe operatori i aeroportit TAV Maqedoni më 25.02.2010 kanë lidhur marrëveshje për bashkëpunim në bazë të marrëveshjes për koncesion në mes Qeverisë së Republikës Maqedonisë dhe operatorit të aeroportit në të cilën janë definuar kushtet për zhvillim, financim, përdorim dhe mirëmbajtje të Aeroporteve “Aleksandri i Madh” Shkup, “Shën Apostol Pavle” Ohër dhe ndërtimi i kargo aeroportit në Shtip. Me marrëveshje vërtetohen të drejtat dhe detyrimet reciproke në fushë të zbatimit të dispozitave doganore, rrethveprimit të bashkëpunimit, koordinimi dhe veprimi i përbashkët me qëllim lehtësimin dhe përshpejtimin e qarkullimit të mallrave dhe pasagjerëve dhe përdorimin efikas të materialeve në dispozicion, burimet teknike dhe njerëzore, sidhe kushtet minimale dhe mënyrën e përcaktimit të hapësirës së punës të organeve doganore.

Në vitin 2010 Drejtoria doganore ka intensifikuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstytucional, që synojnë përparimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave dhe diturive me qëllim përforcimin e mëtejshëm të kapaciteteve për realizimin e qëllimeve në nivel nacional, regjional dhe botëror.

## V. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE NDËRINSTITUCIONAL

**22. Në Ohër është mbajtur konferencë vjetore për vitin 2010 të rajonit të Evropës të OBD**

Më 15 dhe 16 mars 2010 në Ohër është mbajtur konferencë e rregullt vjetore të rajonit të Evropës të OBD nën udhëheqësinë e doganës së Luksemburgit. Në konferencë kanë marrë pjesë 45 delegacione të shërbimeve doganore (nga gjithsejtë 51 vendeve anëtare), Komisioni Evropian dhe OBD, të udhëhequr nga sekretari gjeneral z. Kunio Mikurija, tre udhëheqës të RILO. Temat kryesore të diskutimit ishin përforcimi i luftës kundër falsifikimeve dhe piraterisë, implementimi i standardeve të OBD për përkrahjen e tregtisë dhe forcimi i sigurisë, menaxhimi i koordinuar me kufinj të zhvillimi i sistemit njësportel gjatë ndaljes dhe nevoja nga angazhimi i ekspertëve doganor në qendrat rajonale të trajnimit. Në konferencë u dha mbështetje zhvillimit të menaxhimit me rrezik ndaj 100% skanim dhe propozimit të shërbimit doganor të Ukrainës për formimin qendres rajonale trajnuese të OBD.

**23. Në Shkup është mbajtur mbledhja e dytë të Qendrës trajnuese rajonale të OBD- në Rajoni Evropian**

Më 18 dhe 19 maj 2010 në Qendrën trajnuese rajonale në Shkup është mbajtur mbledhja e dytë të QTR të OBD Rajoni i Europës, në të cilën përveç përfaqësuesve të QTR – Shkup, kanë marrë pjesë përfaqësues të QTR nga Hungaria, Rusia, Ukraina dhe Azerbejxhani, si dhe përfaqësues të Sekretariatit të OBD dhe të Drejtorisë doganore të Luksemburgut, si udhëheqës të atëhershëm të Rajonit të Evropës. Në mbledhje është miratuar plani për trajnim në nivel të QTR për periudhën 2010-2011, drejtime për formimin e platformës së re për mësim në kuadër të QTR, si dhe mundësitë për përdorim më të madh të moduleve për mësim elektronik.

**24. Bashkëpunimi ndërkombëtar bilateral**

Në mars 2010 Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë dhe Drejtoria Doganore dhe tatimore e Holandës publikisht promovuan marrëveshjen e re për bashkëpunim teknik për periudhën 2010-2014. Në pajtim me marrëveshjen, Drejtoria tatimore dhe doganore e Holandës do të siguron ekspertizë Drejtorisë doganore të Maqedonisë për përforcim të mëtejshëm të kapaciteteve në fushën e mbiqyrjes mbi shoqërat tregtare, procedurat doganore me ndikim ekonomik dhe operatorit të autorizuar ekonomik, mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale, laboratoria doganore, bashkëpunimi me DHP, përparimin e sitemit për menaxhimin me burimet njerëzore, futjen e sistemit të kapaciteteve dhe ndryshimin e kultursë së punës dhe forcimin e aftësive komunikuese dhe menaxhuese.



**V. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE NDËRINSTITUCIONAL**

Me 19 nëntor 2010 në Shkup, Drejtoria doganore ka realizuar takim me delegacion të drejtorisë doganore të Republikës së Shqipërisë, në nivel drejtoresh në të cilën u shqyrtuan mundësitë për përparimin e bashkëpunimit me theks të veçantë në vendosjen e shkëmbimit elektronik të të dhënave për tranzit në mes dy shërbimeve doganore.

Me 29 janar 2010 në vendkalimin kufitar Gjueshevë është mbajtur takim i delegacioneve të Drejtorisë doganore të RM dhe Republikës së Bullgarisë. Qëllimi i takimit ishte kontraktimi i aktiviteteve për përparimin e bashkëpunimit bilateral për përshpejtimin e rrjedhjes së mallrave dhe udhëtarëve në pikat kufitare, për parandalimin dhe zbulimin më efikas të tregtisë së paligjshme dhe krimit ndërkufitar, si dhe për përparimin e bashkëpunimit në fusha tjera.

Me 05.03.2010 në Prishtinë është mbajtur takim i delegacioneve të drejtorive doganore të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, të ushëhequr nga drejtorët gjeneral, i cili kishte për qëllim përparimin e bashkëpunimit reciprok për çështje nga fusha e punës doganore, përdorimin e vendkalimit kufitar Gllaboçicë për qarkullim me mallrat komerciale. Me 01.10.2010 të dy palët kanë nënshkruar marrëveshje për shkëmbimin elektronik të të dhënave me anë të sistemit SEED, me zbatimin e të cilit futen standarde më të larta për kontroll doganor dhe përshpejtim dhe lehtësim të rrjedhjes së mallrave në vendkalimet kufitare.



Me 19.02.2010 në vendkalimin kufitar Tabanovc është mbajtur një takim i përbashkët i Komitetit Ekzekutiv të këshillit të biznesit Maqedoni-Serbi të Odave Ekonomike, me përfaqësuesit e drejtorive doganore, organet inspektuese dhe operatorëve ekonomik nga Republika e Maqedonisë dhe Republika e Serbisë. Në takim u theksua roli i organeve doganore në lehtësimin e tregtisë reciproke përmes thjeshtëzimit të formaliteteve doganore dhe futjes e punës doganore elektronike.

Gjatë takimit vjetor të OBD, të mbajtur në qershor 2010, Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë ka nënshkruar memorandum për bashkëpunim me OBD dhe Drejtorinë doganore të Mauriciusit, sipas të cilës Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë do ti ofron ndihmë profesionale për vendosjen dhe zhvillim të sistemit nacional njësportel në Mauricius, që paraqet afirmim i arritjeve të larta në punën doganore. Memorandumin e nënshkruajtën sekretari gjeneral i OBD dhe drejtorët e drejtorive doganore të të dy vendeve. Gjatë takimit vjetor të OBD, Drejtoria doganore e Republikës së Maqedonisë dhe Komiteti shtetëror doganor i Azerbejxhanit kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim në fushën e trajnimit profesional të zyrtarëve doganor, me të cilën parashihet vendosjen e bashkëpunimit të QTR të OBD në Shkup dhe Baku dhe thellimin e bashkëpunimit dypalësh në mes dy shërbimeve doganore.



### V. BASHKËPUNIMI NËRKOMBËTAR DHE NËRINSTITUCIONAL

Me 10.03.2010 Drejtoria doganore dhe shtëpia Konsultative Crown Agents kanë lidhur marrëveshje të re jokomerciale 12 mujorsh për bashkëpunim. Kjo marrëveshje mbulon fushat e zhvillimit të mëtejshëm të kundërzbulimit dhe analizë të rrezikut, ndërsa siguron edhe kornizë juridike për pjesëmarrjen e punonjësve nga Drejtoria doganore në projekte të kësaj shtëpie konsultative në vend të huaj.

#### 25. Bashkëpunimi ndërkombëtar multilateral

Me 19 dhe 20 korrik 2010 në Veneci është mbajtur forum i administratave doganore nga rajoni i Ballkanit perëndimor dhe Turqisë. Forumi kishte për qëllim vërtetimin e strategjive më efikase për përf forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe bashkëpunimit në mes Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

Në nëntor 2010 ka filluar me realizim projekti rajonal për vlerësimin e harmonizuar të kapacitetit administrativ të drejtorive doganore dhe tatimore nga vendet e Ballkanit perëndimor dhe Turqisë, në krahasim me udhëzimet doganore të sjella nga ana e Komisionit Evropian. Projekti është financuar përmes fondeve IPA nga BE.

Në tetor 2010 në Stamboll, në kuadër të forumit të katërt botëror doganor të organizuar nga ana e OBD, nën emrin “Lidhja globale në mes doganës dhe sektorit privat”, në të cilin kanë marrë pjesë më shumë se 400 përfaqësues të sektorit privat, drejtor të doganave dhe akademik të shquar. Drejtoria doganore e RM prezantoi qasjen strategjike në ndërtimin e partneritetit dhe bashkëpunimit me bashkësinë e biznesit përmes punës së trupit këshillëdhënës.

Në nëntor 2010, në kuadër të konferencës së pestë të programit të OBD për partneritet në hetuesin akademik doganore dhe zhvillim të OBD (PICARD-partnership in Customs Academic Research and Development) në Abu Dabi, Drejtoria doganore e RM prezantoi konceptin për forcimin e kapacitetit institucional të Drejtorisë doganore, të bazuar në 3 shtylla: vendosjen e mekanizmave për ruajtjen dhe rritjen e njohurive të memories institucionale, vendosjen e mekanizmave për vetkontrollë intern dhe vendosjen e mekanizmave për zhvillim të vazhdueshëm

#### 26. Bashkëpunimi me bashkësinë e biznesit

Drejtoria doganore edhe në vitin 2010 ka vazhduar ta thellojë bashkëpunimin me bashkësinë e biznesit dhe ta nxisë raportin e bashkëpunimit. Përreth takimeve bilaterale të mbajtura, konferenca dhe prezantime, forma kryesore e bashkëpunimit u zhvillua përmes punës së trupit këshillëdhënës, të cilën e përbëjnë 4 oda ekonomike, shoqëata të transportuesve, shoqëata të shpedituesve ndërkombëtar, asoacioni i kompanive maqedonase për qarkullim rrugor ndërkombëtar dhe Drejtoria doganore. Trupi këshillëdhënës mban së paku një mbledhje në muaj, ndërsa në organizimin e tij janë mbajtur shumë konferenca dhe trajnime. Bashkëpunimi në kuadër të trupit këshillëdhënës ka rezultuar me sjelljen e ndryshimeve në rregullore dhe organizimin e punës të Drejtorisë doganore.

**V. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE NDËRINSTITUCIONAL**

Në bashkëpunim me trupin këshidhënës, në shumë qytete të Maqedonis janë organizuar shumë punëtori me bashkësinë e biznesit në tema aktuale nga puna doganore. Të njëjtët u vizituan masovisht nga operatorët ekonomik të cilët morën pjesë aktive në punëtori. Në bashkëpunim me Odën ekonomike të Maqedonisë, Drejtoria doganore ka organizuar punëtori në të cilën janë përfshi temat: prejardhja e mallrave në rajonin e CEFTA-s, prezantimi i moduleve për doganat dhe biznesin e-learning, procedurat e thjeshtëzuara në punën doganore dhe ATA karnet-rol, përparësitë, përgjegjësitë dhe të drejtat. Punëtoritë janë mbajtur në Shtip, Manastir, Kumanovë, Strumicë, dhe Bogdanci. Në bashkëpunim me AMERIT janë mbajtur punëtori në Ohër Shtip, Kumanovë, Gjevgjeli, Manastir, dhe Strumicë. Tema në punëtori ishin: aplikacioni për dorëzimin elektronik të kërkesave për miratimin e procedurave me ndikim ekonomik, aplikacioni për dorëzimin e kërkesave të ndryshme përmes portlait të jashtëm në EDMS, procedurat e thjeshtëzuara dhe koncepti i operatorit të autorizuar ekonomik dhe krahasimi i kosteve ekzistuese dhe qëndrueshmëria ekonomike e TIR karnetit gjatë kalimit në Shqipëri dhe Greqi në drejtim të Italisë.



Me rastin e një vjetorit të punës së Trupit këshidhënës, në shkurt 2010 është mbajtur në seancë solemne ku morën pjesë biznismenë dhe përfaqësues të mediave. Në seancë u prezentuan rezultatet e arritura nga partneriteti i vendosur në mes doganës dhe bashkësisë së biznesit në drejtim të lehtësimit të tregtisë dhe transportit. Seanca u pasurua me shpërndarjen e diplomave nga OBD anëtarëve të trupit këshidhënës me rastin e 26 janarit ditës ndërkombëtare të OBD, për kontributin e dhënë në zbatimin, përmirësimin dhe përforcimin e partneritetit midis doganës dhe bashkësisë së biznesit, në pajtim me rekomandimet e OBD. Diplomat të nënshkruara nga sekretari gjeneral të OBD z. Kunio Mikurija iu shpërndanë Odës Ekonomike të Maqedonisë, Lidhjes së Odave ekonomike të Maqedonisë, SIZ “Mqedonija sobraqaj”- AMERIT, Asoacionit të sindikatave të pavarura të transportereve me kamion MAKAMTRANS, si dhe gjashtë doganierëve.

**27. Takim koordinative të donatorëve**

Në qershor 2010 në hapësirat e Drejtorisë doganore janë mbajtur mbledhje koordinative të donatorëve në fushën e punës doganore, si vazhdimësi e praktikës së vendosur të takimeve të rregullta për donatorët e interesuar, me qëllim që ndihma e huaj të koordinohet mirë dhe vazhdimisht të plotësohet në interes të Drejtorisë doganore dhe bashkësisë më të gjërë.



V. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE NDËRINSTITUCIONAL

**28. Praktika verore për studentët**

Vazhdon bashkëpunimi i Drejtorisë doganore me institucionet arsimore në Republikën e Maqedonisë përmes organizimit dhe mbajtjes së rregullt të praktikave verore të dedikuara për nxënës të shkollave të mesme dhe studentëve. Në vitin 2010 në praktikat të organizuar nga Drejtoria doganore kanë marrë pjesë gjithsejtë 55 studentë dhe nxënës nga: Fakulteti për Hoteleri dhe Turizëm Ohër, Fakulteti i Ekonomisë pranë Universitetit Shën Qirili dhe Metodi nga Shkupi, Fakulteti për siguri pranë Universitetit Shën Klimenti i Ohrit Manastir- drejtimi siguria dhe kontrolli financiar, Akademia e biznesit Smilevski Shkup dhe Shkolla e mesme elektroteknike të qytetit të Shkupit “Mihajllo Pupin”. Praktikantët janë kryer në njësitë organizative të Drejtorisë doganore, njësite e brendshme doganore, vendkalimet kuiftare, si dhe në drejtorinë qendrore. Studentët dhe nxënësit praktikisht u njoftuan me punën doganore, të ndihmuar nga ana e doganierëve me përvojë.

Drejtorija doganore edhe në vitin 2010 ka vazhduar të praktikoj transparencë maksimale me publikun dhe mediat, me komunikim të drejtpërdrejtë, përgjigje me shkrim dhe informacione, por kryesisht nëpërmjet faqës së internetit.

VI. TRANSPARENCA

29. Faqja e internetit të Drejtorisë doganore



Në dhjetor 2010 është lëshuar në përdorim web faqja e re e Drejtorisë doganore [www.carina.mk](http://www.carina.mk) dhe [www.customs.gov.mk](http://www.customs.gov.mk). Në vitin 2010 në faqen e internetit të Drejtorisë doganore janë publikuar 524 informacione në gjuhën Maqedone, Angleze dhe Shqipe, ndërsa në intranet portalin janë publikuar 275 informacione.

Interesi për faqen e internetit të Drejtorisë doganore në mënyrë intenzive ritet. Në vitin 2010 faqja e internetit është vizituar 1,7 milion herë ku është për 45% më shumë në krahasim me vitin 2009 dhe për 70% më shumë në krahasim me vitin 2008. Në vitin 2010 faqja e internetit e Drejtorisë doganore është vizituar nga 169 mijë vizitorë, ku është për 30% më shumë në krahasim me vitin 2009 dhe për 58% më shumë në krahasim me vitin 2008. Më të vizituar janë skedat “Lajme”, “Kërkimi përmes

Месяц	2008		2009		2010	
	Посети	Посети тели	Посети	Посети тели	Посети	Посети тели
I	95,627	9,593	120,304	13,586	142,460	14,212
II	77,334	8,794	93,727	10,629	171,106	16,487
III	80,131	9,070	97,973	10,686	205,353	20,407
IV	73,411	8,687	97,943	10,599	151,809	13,268
V	70,369	7,874	89,235	10,158	119,444	12,044
VI	64,750	7,030	93,944	10,651	115,066	11,032
VII	70,921	8,205	92,351	9,952	149,070	14,115
VIII	67,967	7,162	81,410	8,921	144,683	13,459
IX	83,118	9,091	97,337	10,668	141,143	13,164
X	99,368	10,210	100,526	10,292	140,736	14,252
XI	97,724	10,353	117,007	11,510	124,880	12,346
XII	105,181	10,797	110,873	11,393	125,383	14,017
<b>Вкупно</b>	<b>985,901</b>	<b>106,866</b>	<b>1,192,630</b>	<b>129,045</b>	<b>1,731,133</b>	<b>168,803</b>

tarifës doganore”, “Pyetje të parashtruara”, dhe “Ligje dhe rregulla”. Nga ana e shfrytëzuesve janë dërguar 1.233 pyetje, ankesa dhe sugjerime (në gjuhën maqedone, shqipe dhe angleze). Përgjigje kanë marrë 648 pyetje ndërsa prej tyre janë publikuar 40 në pjesën për përgjigje në pyetjet e parashtruara më shpesh.

Përmes forumit “pyetje të bëra më shpesh” operatorëve ekonomik iu është mundësuar që të parashtrorjnë pyetje dhe të marrin përgjigje në lidhje me veprimet e lejuara doganore ose përdorim të mallit. Në përdorim është edhe “Info” adresa elektronike përmes të cilës operatorët ekonomik mund të drejtohen deri te Drejtoria doganore për çdo pyetje të hapur nga puna doganore.



### VI. TRANSPARENCA

#### 30. Linja e hapur telefonike 197

Në linjën e hapur telefonike (197) në vitin 2010 janë regjistruar 35.146 thirje (56.963 thirje në 2009) ose në mesatare 96 në ditë nga të cilët 142 thirje kanë të bëjnë me sjelljen joprofesionale të doganierëve dhe të njëjtat janë dërguar deri te seksioni për Përgjegjësi profesionale, ndërsa 173 thirje janë informata të cilat janë dërguar në përpunim te njëtitë tjera organizative kompetente të Drejtorisë doganore.

#### 31. Ankesa dhe sugjerime

Në gusht 2010 është sjellë Udhëzim për veprim sipas ankesave dhe sugjerimeve në Drejtorinë doganore, me të cilin rregullohet veprimi sipas ankesave dhe sugjerimeve të parashtruara deri te Drejtoria doganore, me qëllim mbrojtja dhe realizimi i të drejtave dhe interesave të aplikanteve, interesave publike të caktuara me ligj, ose me qëllim ngritjen e një iniciative tjetër nga interesi publik. Në vitin 2010 janë pranuar 3 ankesa dhe sugjerime dhe ndaj të njëjtave është vepruar siç duhet.